



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Adresa: Rruga Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; www-site:www.klsh.org.al

Nr. 1337/ 40 Prot.

Tiranë, më 30.06.2019

V E N D I M

Nr. 04, Datë 30.06.2019

PËR

AUDITIMIN E USHTRUAR NË 13 SUBJEKTE TË AUDITUARA PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E EVADUARA PËR PERIUDHËN 01.01.2018 DERI 01.08.2018, NGA DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE, RESPEKTIVISHT NË BASHKITË: KUÇOVË, LEZHË, LEZHË (ish Komunat), LUSHNJË, MALLAKASTËR, KONISPOL, KËLCYRË, KORÇË, KOLONJË, PUSTEC, POLIÇAN, VAU-DEJËS DHE KËSHILLI I QARKUT BERAT”

Pasi u njoha me Raportet Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30, të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportet Përfundimtare të Auditimit “Mbi Verifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e evaduar për periudhën 01.01.2018 deri 01.08.2018”, të ushtruar në 13Subjekte, respektivisht bashkitë: *Kuçovë, Lezhë, Lezhë (Ish Komunat), Lushnjë, Mallakastër, Konispol, Këlcyrë, Korçë, Kolonjë, Pustec, Poliçan, Vau-Dejës dhe Këshilli i Qarkut Berat*, sipas programit të auditimit Nr. 1337Prot., datë 03.12.2018, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

a-Mbi kthimin e përgjigjes të zbatimit të rekomandimeve të KLSH brenda afatit 20 ditor, hartimi i Planveprimeve (programeve) të punës dhe raportimi në KLSH mbi ecurinë e zbatimit rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga 13 subjektet e verifikuara, në përgjithësi Subjektet kanë kthyer përgjigje KLSH-së, brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, duke hartuar edhe planet e veprimit (programet e punës), por vetëm 2 subjekte Bashkia Këlcyrë dhe Bashkia Pustec nuk kanë raportuar në KLSH me shkrim mbi ecurinë e zbatimit rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me pikën 2, nenin 30 i ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ku përcaktohet se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna".

b-Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

Nga verifikimi rezultoi se nga subjektet e audituara, detyrimin për të raportuar në Këshillin Bashkiak nuk e kanë zbatuar 3 Bashkitë: **Kuçovë, Lushnje dhe Bashkia Këlcyrë**. Nuk është raportuar rregullisht në këshillin e njësisë (Këshillin Bashkiak), kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjor, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

Realizimi i zbatimit të rekomandimeve sipas llojit të tyre paraqitet si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga auditimi i realizuar në 13 subjektet e verifikuara për zbatimin e detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimet e evaduara për periudhën 01.01.2018 deri 31.12.2018, rezultoi një nivel i pranueshëm zbatueshmërie në **masën 99%, nga 166 masa organizative** të rekomanduara janë pranuar **165** masat. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 71 masa ose në masën 43 %, nuk janë zbatuar 17 masa, në masën 10 %, ndërsa 77 masa, në masën 47 %, janë në proces zbatimi. Subjektet të cilat nuk kanë zbatuar masat organizative të rekomanduara nga KLSH përmendim Bashkitë: *Vau Dejës 4 masa, Poliçan 3 masa, Pustec 2 masa, Këlcyrë 3 masa, Lushnje 1 masë dhe Lezhë 2 masa.* (Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet në Aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij Vendimi)

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Në 13 subjektet e audituara për zbatimin e detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimet e evaduara për periudhën 01.01.2018 deri 31.12.2018, konstatohet se nga vlera e rekomanduar për 119 masa shpërblim dëmi prej **277,662 mijë lekë** të cilat janë pranuar në masën 91% prej tyre janë në proces gjyqësor apo kanë dalë urdhrat e ekzekutimit, pra janë në proces zbatimi 76 masa në vlerën **203,093 mijë lekë** ose në masën 70%, duke mos u pranuar apo pa mundësi arkëtimi 18 masa shpërblim dëmi në vlerën prej **46,014 mijë lekë, respektivisht:**

-vlera prej 16,574 mijë lekë i përket Bashkisë Vau-Dejës, rekomandime të cilat përfaqësojnë detyrimet kontraktuale për arkëtimin e vlerave të përcaktuara në kontratat e lidhura midis bashkisë dhe subjekteve private, për pasuritë e dhëna me qira si pyje, kullota dhe toka inproduktive për të cilën nuk pranohet nga Bashkia Vau-Dejës me pretendimin se ekziston kontrata me subjektet.

-**vlera prej 12,826 mijë lekë**, i përket Bashkisë Poličan, rekomandime të cilat përfaqësojnë shkeljet në procedura prokurimi me dëm ekonomiksi rezultat i përlllogaritjes gabim të vlerës së fondit limit, të cilat Bashkia Poličan nuk i ka pranuar.

- **vlera 10,295 mijë lekë**, i përket Bashkisë Mallakastër, vlerë e cila në pjesën më të madhe përfaqëson detyrimin e ngarkuar antarëve të KVO me dëm ekonomik, për të cilat nga ana e bashkisë është ngritur komision i hetimit administrativ, ku në të gjitha rastet është vlerësuar se nuk ka dëm ekonomik gjë e cila ka sjell dhe mos arkëtimin e shumës së mësipërme.

- **vlera 2,400 mijë lekë**, i përket Bashkisë Kuçovë e cila përfaqëson 8 gjobat e vendosuar nga IMTVpor, edhe pse kanë kaluar mbi 2 vjet nga data e vendosjes së tyre, nuk kanë filluar procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e shumave etj.

C.MASAT DISIPLINORE DHE ADMINISTRATIVE:

Në 13 subjektet e verifikuara për zbatim të rekomandimeve nga KLSH janë rekomanduar masa administrative apo masa për fillimin e procedurave disiplinore për **263 masa**, nga të cilat ka 1 masë të papranuar nga ana e Bashkisë Lushnjë, duke u pranuar **262 masat** të cilat janë shqyrtuar në komisionet disiplinore apo APP dhe prej tyre janë zbatuar **134 masa** ose në nivelin **51%**, duke mos u zbatuar **101 masa** ose në nivelin **38 %**, prej tyre rreth 48 masa i përkasin Bashkisë Kuçovë nga të cilat 30 masa përbëjnë gjoba të vendosura sipas Vendimit të APP-së nr. 108, datë 07.11.2018 pjesa më e madhe e të cilave janë në proces gjyqësor.

(Në mënyrë të detajuar realizimi i masave disiplinore dhe administrative paraqitet ne Aneksin nr. 2,3, bashkëlidhur këtij Vendimi)

Ndërsa realizimi i rekomandimeve për secilin nga 13 subjektet në mënyrë të detajuar paraqitet si më poshtë:

1.BASHKIAKUÇOVË:

-Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Kuçovë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 54/13, datë 18.06.2018, protokolluar në Bashkinë Kuçovë me shkresën nr. 202/82, datë 20.06.2018, ndërsa nga Bashkia Kuçovë për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 202/83 datë 09.07.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 54/16 datë 11.07.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes.

A.MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Kuçovë 11 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 9 masa, janë në proces zbatimi 3 masa dhe 2 masa organizative nuk janë zbatuar për të cilat rikërkojmë zbatimin e tyre si vijon:

1.10. Gjetje nga auditimi: Në investimin me objekt **“Rikonstrukcion i banesave të komunitet Rom në fshatin Vodës, Lumas”** për të cilin është lidhur kontrata e sipërmarrjes me OE “P.” sh.p.k, sipas aktit me nr. 48, Prot., datë 20.03.2013, me vlerë të kontratës 9,634,354 lekë me TVSH, nga inspektimi në objekt i 10 banesave nga 22 në total, u konstatua se në çdo njëërën prej tyre punimet ishin me mangësi si dhe me diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën 762,481 lekë pa TVSH.

Gjithashtu u konstatuan se në shumë raste ka punime dhe procese apo zëra pune jo të përfunduara plotësisht duke u bërë shkak për praninë e lagështisë apo degradimin e ambienteve të banesave. Në dy raste u konstatua se volumet e punës për tualetet janë përlllogaritur një herë si volume pune së bashku me volumet e shtëpisë dhe një herë si volume pune sipas zërit **“Ndërtim ambient tualeti jashtë”**. Në disa raste dritaret ishin të pasilikonuara. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 4, 7 dhe 12, të ligjit nr. 8402 **“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”** i ndryshuar, Udhëzimin e KM nr. 3 datë 15.02.2001 **“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të**

ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, pika 9 dhe Udhëzimin e KM nr. 1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika b, nr. 3.3 paragrafi i dytë (Trajtuar më hollësisht në faqe 125-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.10.1. Rekomandim: Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa, nëpërmjet një grupi specialistësh përkatës sipas nevojave të investimit, për verifikimin e objekteve të pa inspektuara në terren nga përfaqësuesit e KLSH-së, respektivisht objekt “Rikonstruksion i banesave të komunitet Rom në fshatin Vodës, Lumas” dhe objektin “Rikualifikim urban i lagjes 11 janari, Kuçovë” me qëllim identifikimin si dhe arkëtimin e vlerës së punimeve për volumet e punës të likuiduara por të pakryera në fakt në 12 nga 22 banesat e pa inspektuara si dhe korrigjimin e mangësive të punimeve si pasojë e cilësisë së dobët të zbatimit në të gjitha banesat.

Menjëherë

2.11. Gjetje nga auditimi: KLSH ka ushtruar auditim për periudhën 2013-2015 dhe me shkresën nr. 32/6, datë 30.4.2015 ka adresuar gjetjet dhe rekomandimet në Bashkinë Kuçovë. Nga verifikimi rezultoi se deri më datën 30.03.2018, rekomandimet e dërguara nga KLSH meshkresën nr. 32/6, datë 30.04.2015, protokolluar në Bashkinë Kuçovë me nr. 51/48 dt. 06.05.2015 nga vlera e rekomanduar për masa shpërblim dëmi prej 24,941,331 lekë, është pranuar vlera 1,079,301 lekë e cila është kontabilizuar, deri më datën 16.03.2018 ishte arkëtuar vlera prej 976,666 lekë, ndërkohë nuk është pranuar vlera prej 23,862,030 lekë. Për rekomandimet e pa zbatuara me vendimin e kryetarit të KLSH-së nr.32, datë 31.03.2016 përcjellë në Bashkinë Kuçovë me shkresën nr. 1015/62 datë 05.04.2016, i është rikërkuar zbatimi i këtyre rekomandimeve Kryetarit të Bashkisë dalë pas zgjedhjeve të vitit 2015, por nuk është ndërmarrë asnjë veprim (Trajtuar më hollësisht në faqet 7 -19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.11.1 Rekomandim: Nga kryetari i Bashkisë Kuçovë të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin dhe arkëtimin e dëmit të shkaktuar Bashkisë Kuçovë për rekomandimet e lëna në auditin e mëparshëm dhe dërguar meshkresën e KLSH-së nr. 32/6, datë 30.04.2015, protokolluar në Bashkinë Kuçovë me nr. 51/48, datë 06.05.2015 të cilat nuk janë pranuar në 9 raste në vlerën prej **24,068,830 lekë**, të analizuar në faqen 7-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b)-Të drejtat e KLSH- së, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i njësisë publike Bashkia Kuçovë, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e vlerës. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin me qëllim arkëtimin e **vlerës 20,125,153 lekë**, nga e cila dëm ekonomik në vlerën 5,316,690 lekë dhe të ardhura të munguara me dëm ekonomik në vlerën 14,808,463 lekë.

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar e pranuar nga KLSH prej.....**17,724,101 lekë**

-Deri më datën 31.01.2019 është arkëtuar 161,716 lekë

Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej.....17,562,385 lekë

Nga të cilat:

-Në proces arkëtimi 1 rekomandim në vlerën.....1,278,982 lekë

-Janë nisur njoftimet për 7 rekomandime por ende nuk kanë filluar arkëtimet.....14,572,449 lekë

-Vendosur sekuestro në Thesar për bllokim garancie 2 rekomandime1,710,954lekë

Për zbatimin e rekomandimeve të pa realizuara me dëm ekonomik i rikërkojmë Bashkisë Kuçovë, si më poshtë:

1.1. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i saktësisë së pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për lejet e ndërtimit të dhëna për 2 vitet 2016-2017, rezulton se për 9 subjekte janë përlloritur më pak duke shkaktuar buxhetit të Bashkisë mungesë të ardhurash me **dëm ekonomik në vlerën 1,339,750 lekë**. Në kundërshtim me çmimet e përcaktuara në dy Udhëzimet e KM nr.4, datë 30.09.2015, “Për entin Kombëtar të Banesave për vitin 2015” dhe Udhëzimin e KM nr.3, datë 28.12.2016, “Për entin Kombëtar të Banesave për vitin 2016”, nenin 46-Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, të ligjit nr. 107/2014 datë 01.10.2014 i ndryshuar dhe nenin 27, të ligjit nr. 142/2015, për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore” (*Trajtuar më hollësisht në faqe 167 -172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.1 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Kuçovë, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të merren masa për arkëtimin e vlerës taksës së ndikimit në infrastrukturë të paguar më pak për 9 subjekte në vlerën **1,339,750 lekë** respektivisht:

A. A. H. në vlerën 1,181,059 lekë, S. M. në vlerën 19,311 lekë, G. A. në vlerën 24,640 lekë, I. M. në vlerën 9,262 lekë, L. S. në vlerën 12,516 lekë, A. M. në vlerën 16,985 lekë, B. D. në vlerën 51,995 lekë, M. T. në vlerën 8,773 lekë dhe Shoqëria “A.” shpk në vlerën 15,209 lekë.

Menjëherë

2.3. Gjetje nga auditimi: Nga ana e ish kryetarit të komunës Lumas z. **Z. S.** nëpërmjet procedurës për blerje të vogla është marrë me qira mjeti tip Tip Benz me targë AA184AY për nevoja të administratës së komunës Lumas, duke lidhur kontratë me një person të palicencuar më organet tatimore në vlerën 115,000 lekë, respektivisht për vitin 2013 në vlerën 60,000 lekë/vit dhe vitin 2014 në vlerën 55,000 lekë/vit. Në fakt është paguar **vlera prej 70,000 lekë**, për vitin 2013 vlera 30,000 lekë dhe vitin 2014 për 40,000 lekë. Në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa (a, b, d, dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” dhe pikës 12 të nenit 3 të ligjit mësipërm, ku përcaktohet që: 12. Kontraktues, “furnizues” dhe “sipërmarrës i shërbimit” është çdo person fizik, juridik apo ent publik ose grup personash dhe/ose organesh të tilla, që ofrojnë në treg si për marrjen e një ose disa punëve, furnizimin me mallra ose shërbime (*Trajtuar më hollësisht në faqe 116 -120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.3.1 Rekomandim: Bashkia Kuçovë të nxjerrë urdhër ekzekutimin dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës **70,000 lekë** nga z. **Z. S.** ish kryetari i komunës Lumas si urdhërues për kryerjen e 2 procedurave të prokurimit në blerje të vogla për marrjen me qira për nevoja të komunës të mjetit tip Tip Benz me targë AA184AY për vitet 2013-2014 duke lidhur kontratë me një person të palicencuar më organet tatimore.

Menjëherë

3.4. Gjetje nga auditimi: Përveç shkeljes së procedurës së prokurimit për marrjen me qira të mjetit tip Tip Benz me targë AA184AY, për 2 vitet 2013-2014 janë tërhequr nga magazina 3800 litra naftë në vlerën **676,840 lekë**, ndërkohë magazinieri z. F. S. i cili ka qenë edhe drejtuesi i mjetit, në fletëdaljen e karburantit ka firmosur edhe si marës i karburantit (pra ja ka bërë dalje vetes vet). Fletëdaljet nuk janë pajisur me urdhër dorëzimi nga ish kryetari i komunës dhe nuk janë prerë dhe mbyllur në fund të muajit por sipas hyrjes së mallrave. Gjithashtu nuk janë administruar tollonat e karburantit si letra me vlerë. Veprime në kundërshtim me pikat 36 dhe 38 të Udhëzimit Ministrisë Financave nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve të Njësive të Sektorit Publik” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014 dhe udhëzimin nr.11, datë 06.05.2016, kreu III - Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre (*Trajtuar më hollësisht në faqe 116 -120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.4.1 Rekomandim: Bashkia Kuçovë të nxjerrë urdhër ekzekutimin dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës **676,840 lekë** nga z. **F. S.** ish magazinier i ish komunës Lumas, i cili njëherazi ka qenë edhe drejtuesi i mjetit, Tip Benz me targë AA184AY, pasi pa u pajisur me autorizim për furnizim me

karburant nga ish kryetari i Komunës, në fletëdaljen e karburantit ka firmosur edhe si marrës i karburantit (pra ja ka bërë dalje karburantit vetes vet).

Menjëherë

4.5. Gjetje nga auditimi: Janë kryer pagesa për bonus transporti padrejtësisht për 12 muaj të periudhës dhjetor 2012-2013-shkurt 2014 nga 15,000 lekë/muaj për z. **Z. S.** ish kryetar i komunës Lumas, në kundërshtim me ligjin nr. 169/2013, datë 7.11.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 "Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë", i ndryshuar me ligjin nr. 169/2013 miratuar më datë 07.11.2013, **me pasojë dëmin ekonomik në shumën 189,000 lekë** (konstatohet se z. **Z. S.** ish kryetar i komunës Lumas, *bonusin e transportit prej 15,000 lekë, për muajin tetor 2013 e ka marrë gabimisht 2 here, njëherë me urdhër shpenzimin nr. 121, datë 11.11.2013 për vlerën 15,000 lekë dhe përsëri me urdhër shpenzimin nr. 11, datë 05.02.2014 për vlerën 15,000 lekë (Trajtuar më hollësisht në faqe 116 -120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.5.1 Rekomandim: Bashkia Kuçovë të nxjerrë urdhër ekzekutimin dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës **189,000 lekë** nga z. **Z. S.** ish kryetari i komunës Lumas për përfitimin padrejtësisht bonus transporti për 12 muaj të periudhës dhjetor 2012 -2013-shkurt 2014 nga 15,000 lekë/muaj.

Menjëherë

5.6. Gjetje nga auditimi: Janë kryer pagesa për bonus transporti padrejtësisht për 12 muaj të periudhës dhjetor 2012 -2013 nga 15,000 lekë/muaj për z. **M. H.**, ish kryetar i komunës Kozare, në kundërshtim me ligjin nr. 169/2013, datë 7.11.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 "Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë", i ndryshuar me ligjin nr. 169/2013 miratuar më datë 07.11.2013, **me pasojë dëmin ekonomik në shumën 180,000 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqe 120 -125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.6.1 Rekomandim: Bashkia Kuçovë të nxjerrë urdhër ekzekutimin dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës **180,000 lekë** nga z. **M. H.**, ish kryetar i komunës Kozare për përfitimin padrejtësisht bonus transporti për 12 muaj të periudhës dhjetor 2012 -2013-shkurt 2014 nga 15,000 lekë/muaj.

Menjëherë

6.7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt nga operator ekonomik **“P.”**, dëm ekonomik në vlerën **1,189,730 lekë pa TVSH**, në 3 objektet **si mëposhtë:**

a. Vlerën 762,481 lekë pa TVSH, në objektin “Rikonstruksion i banesave të komunitet Rom në fshatin Vodës, Lumas”, Kuçovë, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 48, prot. datë 20.03.2013 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kuçovë dhe OE “P.” sh.p.k (Trajtuar më hollësisht në faqe 120 -125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

b. Vlerën 320,284 lekë pa TVSH, në objektin “Rikonstruksion i institucioneve arsimore”, Kuçovë, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3549, prot datë 28.10.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kuçovë dhe OE “P.” sh.p.k. (Trajtuar më hollësisht në faqe 133-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

c. Vlerën 106,965 lekë pa TVSH, në objektin “Mirëmbajtjen e Varrezave Publike, Bashkia Kuçovë”, për sa janë situacionuar më shumë se sa janë preventivuar 3 zëra punimesh , parashikuar në nenin 8.2 të Kontratës sipërmarrjes të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Kuçovë dhe operatorit ekonomik **“P.” shpk**, sipas kontratës nr. 1516, prot, datë 11.05.2016 me afat 5 vite deri në 11.05.2021 (Trajtuar më hollësisht në faqe 36-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.7.1. Rekomandim: Nga Bashkia Kuçovë të merren masa për arkëtimin nga operatori ekonomik **“P.”** për vlerën **1,189,730 lekë pa TVSH**, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit, në 3 objektet si më poshtë:

a. për arkëtimin e vlerës 762,481 lekë pa TVSH, nga operatori ekonomik **“P.”** sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 48 prot datë 20.03.2013 me objekt “Rikonstruksion i banesave të komunitet Rom në fshatin Vodës, Lumas”, Kuçovë .

b. për arkëtimin e vlerës **320,284 lekë pa TVSH**, nga operatori ekonomik “P.” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 3549, datë 28.10.2016 me objekt “*Rikonstruksion i institucioneve arsimore*”, Kuçovë.

c. për arkëtimin e vlerës **106,965 lekë**, apo kryerjen e ndalesës, ndaj operatori ekonomik “P.” shpk, sipas kontratës me nr.1516, datë 11.05.2016 me afat 5 vite deri në 11.05.2021 (*shumë e cila ende deri më datën 30.03.2017 nuk është likuiduar*)

Menjëherë

7.8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt nga operator ekonomik “Z.” dëm ekonomik në vlerën **365,885 lekë pa TVSH**, në 2 objektet **si më poshtë:**

a. Vlerën 157,710 lekë pa TVSH, në objektin “*Rikonstruksioni i Rrugës Kongresi i Lushnjës*”, Kuçovë, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3105, prot datë 21.09.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kuçovë dhe OE “Z.” sh.p.k. (*Trajtuar më hollësisht në faqe 133-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

b. Vlerën 208,175 lekë pa TVSH, në objektin “*Rehabilitim i pjesshëm Skema e Ujitjes Perondi*”, Kuçovë, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2015 prot datë 22.06.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kuçovë dhe OE “Z.” sh.p.k. (*Trajtuar më hollësisht në faqe 125 -144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.8.1. Rekomandim: Nga Bashkia Kuçovë të merren masa për arkëtimin nga operatori ekonomik “Z.” për vlerën **365,885 lekë pa TVSH**, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit në **2 objektet si mëposhtë:**

a. Vlerën 157,710 lekë pa TVSH, nga OE “Z.” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 3105, datë 21.09.2016 me objekt “*Rikonstruksioni i Rrugës Kongresi i Lushnjës*”, Kuçovë.

b. Vlerën 208,175 lekë pa TVSH, nga OE “Z.” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2015, datë 22.06.2016, në objektin “*Rehabilitim i pjesshëm Skema e Ujitjes Perondi*”, Kuçovë.

Menjëherë

8.9. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Rikonstruksioni i shkallëve të pikës turistike*”, Kuçovë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **363,920 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2557, prot datë 02.08.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kuçovë dhe BOE “A.” sh.p.k dhe “S.” sh.p.k. (*Trajtuar në faqe 125 -144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.9.1. Rekomandim: Nga Bashkia Kuçovë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **363,920 lekë pa TVSH** nga BOE “A.” sh.p.k dhe “S.” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2557 Prot., datë 02.08.2016 me objekt “*Rikonstruksioni i shkallëve të pikës turistike*”, Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë

9.10. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të bankës së ish Komunën Lumas, rezulton se sipas situacionit përfundimtar vjetor urdhër shpenzimin nr. 137, dt.03.12.2013 Fatura tatimore nr .09835273 datë 02.12.2013 urdhër shpenzimin nr. 74, dt.28.05.2015, në vleftën e situacionit përfundimtar është shtuar dhe financuar zëri i punimeve Hartim projekti+ preventiv zbatimi + projekt ide 2.5 është, pa u mbështetur në dispozitë ligjore apo nënligjore duke i likuiduar padrejtësisht më tepër edhe vlerën 872,565 dëm ekonomik pa TVSH. Akt kolaudimi datë 10.02.2015 objekti është realizuar më dt. 24.01.2015. Sipërmarrësi **T. dhe B.** shpk, mbikqyrës i punimeve Z. shpk Ing. R. T. me NUIS K617. dhe kolaudatore Ing.L. P.. Akt dorëzimi dt. 18.02.2015 nënshkruar nga ish kryetari i komunës Lumas z. Z. S. dhe marësve në dorëzim: B. C., K. M. dhe A. Q..

Në hartimin e Preventivit dhe Situacionit Përfundimtar të punimeve për objektin: Sistemim-Asfaltimi i Rrugës Fshatit Shqez-Vodez-Koritez Faza e parë Komuna Lumas nuk është mbajtur parasysh

Modelit TIP i hartimit (**Preventivitet dhe Situacionit**), përcaktuar në pikat 3. 3.1-Preventivat... dhe 3.3-Situacionet, të Udhëzimit KM nr. 01, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e KM nr. 03, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”

9.10.1.Rekomandim: Bashkia Kuçovë të nxjerrë urdhër ekzekutimin dhe të merren masa për arkëtimin e vlerës **872,565 lekë pa TVSH**, nga Shoqëria “T.” dhe “B.” Sh.p.k, pasi kjo vlerë është shtuar në preventivin e punimeve, të objektit: Sistemim-Asfaltimi i Rrugës Fshatit Sheqez-Vodez-Koritez Faza e I-rë, pa u mbështetur në dispozitë ligjore apo nënligjore dhe financuar padrejtësisht zëri i punimeve Hartim projekti+ preventiv zbatimi + projekt ide në masën 2.5 % mbi vlerën e preventivit 34,902,600 lekë.

Menjëherë

10.11 Gjetje nga auditimi: Nga 2-ish Komunitat Lumas dhe Perondi për periudhën 2009-2013 u janë dhënë me qira 433 qiramarësve toka bujqësore shtetërore të pandara për sipërfaqen prej 390 ha, me afat nga 10 deri 99 vjet, respektivisht: Njësia Administrative Lumas 187 ha për 181 kontrata dhe Perondi me 203 ha për 252 kontrata. Me kërkesën e grupit të auditimit të KLSH-së, gjatë periudhës së auditimit, u nxorën dhe rakorduan të dhënat për periudhën nga viti 2012 deri më datën 31.12.2017 për qiranë e tokave të pandara, respektivisht për 2 ish-komunitat, aktualisht Njësiti Administrative, Lumas dhe Perondi, dhe rezultoi se **277 qiramarrës nuk kanë** paguar vlerën e qerasë për të cilën u kërkua llogaritja e kamat vonesave si e ardhur e **munguar me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Kuçovë në vlerën prej 12,387,911 lekë sipas Aneksit nga numri 1 deri 4 (Trajtuar më hollësisht në faqe 144 -152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

Nga 2 ish-Komunitat Lumas dhe Perondi pas reformës territoriale dhe bashkimin me Bashkinë Kuçovë, në asnjë rast për dhënien me qira për tokat shtetërore të pandara (pavarësisht se pjesa me e madhe sipërfaqes janë mbjelle me ullinj), nuk është bërë kontrolli i respektimit të kushteve të kontratës, në kundërshtim me pikën 5, shkronja (d) të Udhëzimit KM nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara” (Trajtuar nga faqja 144-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.11.1 Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Drejtoria e Financës Bashkia Kuçovë të marrin masa për njoftimin e 277 Fermerëve të cilat nuk kanë paguar vlerën e qirasë dhe kamat-vonesave në masën 1% në ditë të cilat janë parashikuar në kontratat e lidhura ndërmjet palëve gjatë periudhës 2009-2013 për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara për vlerën **12,387,911 lekë**.

-Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të ngrëjë një grup pune me pjesëmarrjen Drejtorisë së Taksave, Drejtorisë së Financës, Drejtorisë së Bujqësisë, Drejtorisë Juridike, Topografë, Njësive Administrative, etj., me qëllim verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në 433 kontratat e lidhura për dhënien me qira në vite të tokave bujqësore shtetërore të pandara, për sipërfaqen prej 390 ha. Krahas kësaj të kryhet edhe kontrolli i statusit juridik të tokave bujqësore të dhëna me qira (Pajisja me Certificate regjistrimi në Hipotekë, etj, në 3 Njësiti Administrative të Bashkisë Kuçovë Lumas, Perondi dhe Kozare). Përveç sipërfaqes tokës së dhënë me qira, të verifikohen edhe rastet e zaptimit të tokës, mbi sasinë e përcaktuar në kontratat dy paleshe apo zaptime toke pa asnjë lloj dokumentacioni.

Menjëherë

11.12.Gjetje nga auditimi:

Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Financës rezulton se nga IMTV Kuçovë nga vitet e mëparshme janë vendosur 8 gjoba vlera e të cilave janë pasqyruar në kontabilitet në shumën prej **2,401,052 lekë**, (pa vlerën e kamat vonesave), por edhe pse kanë kaluar mbi 2 vjet nga data e vendosjes tyre, nuk kanë filluar procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e tyre, në kundërshtim me nenin 46, të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”. Nga shuma e 8 vendimeve të gjobave të vendosura në vite dhe të pa arkëtuara deri më datën 16.03.2018 në vlerën 2,401,052 lekë, analizohen si më poshtë:

a-Për 2 vendime gjobash në vlerën 367,348 lekë pretendohet se janë kthyer në tituj ekzekutiv nga gjykata, në vitin 2012 (por nuk gjenden vendimet e gjykatës), pra deri më datën 30.03.2018 edhe pse kanë kaluar 7.5 vjet ende nuk janë ekzekutuar.

b-Për 2 vendime gjobash në vlerën 600,000 lekë janë kthyer në tituj ekzekutiv nga gjykata në vitin 2012 por deri më datën 30.03.2018 edhe pse kanë kaluar 7.5 vjet ende nuk janë ekzekutuar.

c-Për 4 vendime gjobash në vlerën 1,400,000 lekë, nga gjykata në vitin 2014 janë kthyer në tituj ekzekutiv, por deri më datën 30.03.2018 edhe pse kanë kaluar 5 vjet ende nuk janë ekzekutuar. Në kundërshtim me ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996, "Kodi i Procedurës Civile në RSH" i ndryshuar, nenet 17 dhe 55- Vënia në ekzekutim, shkronja (ç) ku përcaktohet se: Vënia në ekzekutim e urdhrat të ekzekutimi bëhet brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të kreditorit (Trajtuar më hollësisht në faqet 154 -162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.12.1 Rekomandimi: Bashkia Kuçovë Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, bazuar në nenet 151 dhe 152, të "Kodit Procedurës Civile në RSH", të marin masat dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për vendimet me gjobë për ndërtimet e kundërligjshme, të vendosura për periudhën 2009-2015 **në vlerën 2,401,052 lekë**, (duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve" i ndryshuar) Njëherazi të marrin masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv në zbatim të nenit 24-*Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv*, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" (*Sipas Pasqyrës që administron IMTV Bashkia Kuçovë*).

Menjëherë

12.13 Gjetje nga auditimi: Në 5 raste është paguar qytetari B. A. nëpërmjet xhirimit në numrin e llogarisë për shpenzime për qiranë e shkollës Bardhaj sipas kontratës nr. prot ska datë 13.02.2013 me vlerë 40,000 lekë. Urdhëruesi ish kryetari i Komunës Lumas z.Z. S. dhe kontabilistja Përgjegjës e Degës financës znj.B. D.. Për këtë pagesë nuk është ndalur tatimi në burim në masën 15 %, në kundërshtim me nenin 33, pika 1, shkronja "f", të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, duke shkaktuar dëm ekonomik **në vlerën 19,500 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqe 116 -120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.13.1 Rekomandim: Bashkia Kuçovë të nxjerrë urdher ekzekutimin dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës **19,500 lekë** nga qytetari B. A., sa nuk ka paguar tatimin në burim për qiranë e shkollës Bardhaj sipas kontratës nr. prot ska datë 13.02.2013.

Menjëherë

C. MASAT DISIPLINORE:

C. 2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës:

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-sëtë ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, neni 14-Masat disiplinore shkronja (b), **KLSH i rikërkon Kryetarit të Bashkisë Kuçovë** që ti rikërkojë Komisionit Disiplinor fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore si më poshtë:

a. "Vërejtje me paralajmërim", për 16 punonjësit e mëposhtëm:

- 1. znj. E. G.**, Specialiste kontabiliteti.
- 2. z.L. Z.**, Inspektor i kontrollit borxhit e koordinimit.
- 3. z.D. S.**, Inspektore e regjistrimit dhe procedurave.
- 4.z.S. L.**, Përgjegjës i agjencisë, inspektor i taksapaguesve, Njësia administrative Kuçovë.
- 5. z.T. P.**, Agjent tatimor.
- 6. z.Th. B.**, Agjent tatimor Njësia Kuçovë.
- 7. z. K. M.**, Administrator i Njesisë Administrative Lumas.
- 8. znj.E. D.**, Mbikqyrse (Inspektore taksapaguesve) në Njësine Administrative Lumas.
- 9. z.F. B.** Administrator i Njesisë administrative Kozare.
- 10.z.B. S.** Inspektor i tatimpaguesve në Njesisë administrative Kozare.
- 11. z.A. D.**, Administrator i Njesisë Administrative Perondi.
- 12. z.L. Sh.**, Inspektor i taksapaguesve i Njesisë Administrative Perondi.
- 13. z.A. D.**, Kryeinspektor i Inspektoratit Mbrojtjes Territorit (IMTV).

14.z.R. B., Inspektor (IMTV).

15. z. F. P., me detyrë Drejtor i Planifikim Zhvillim Territorit.

16. z. J. L., inspektor në IMTV Kuçovë.

D. MASA ADMINISTRATIVE:

d.1. Mbi gjobat e rekomanduara Agjencisë prokurimit Publik.

I. Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2017, si dhe përgjegjesisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **KLSH i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin e Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), ndaj 14 punonjësve, për procedurat e prokurimit.**

Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 94, datë 19.09.2018, percjellë për në Bashkinë Kuçovë dhe KLSH-në me shkresënr. 6312/3, datë 19.09.2018, e cila është protokolluar në Bashkinë Kuçovë me shkresën nr. 3174 prot., datë 21.09.2018 duke vendosur masa dënim me gjobë për 22 persona në vlerën në total prej 1.950.000 lekë.

Për gjobat e vendosura nga APP, me vendimin nr. 94, datë 19.09.2018, nga Bashkia Kuçovë Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës të kontabilizohen vlera e vendimeve të gjobave të vendosura nga APP, KLSH rikontraston të meren masat e mëposhtme:

a) të marrë masa për kthimin në tituj ekzekutiv të vendimeve të gjobave të APP të mbetura pa u arkëtuar, në zbatim të nenit 24-Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

b) Bazuar në ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, për vendimet e gjobave të vendosura nga APP, për të cilat nuk kanë filluar procedurat e nevojshme ligjore pika 5) **ku parashikohet se:neni 44” Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”**, në rast se gjobat dhe detyrimet e tjera, të vendosura nga vendimi për kundërvajtjen administrative, nuk paguhen për mosveprim të punonjësit të organit administrativ, i cili ka miratuar vendimin përkatës dhe detyrimin që të kërkojë arkëtimin e shumave, apo për shkak se punonjësi nuk nis procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ, **atëherë ndaj tij fillojnë procedurat e largimit nga puna.**

e) Bazuar në ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 4. Përgjegjësia për vjeljen e gjobave, të vendosura sipas pikës 1, të këtij neni, është e autoritetit kontraktor.

D.2. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit (IMTV) Bashkia Kuçovë.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenet 7 dhe 12, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimi e KM nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitet individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe shpjegimet dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr.183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **KLSH irekomandon Kryetarit të Bashkisë Kuçovë qet’i rikërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit**

të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë për 3 mbikëqyrës dhe 1 kolaudator punimesh, si më poshtë:

1. V. T. nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.
2. E. M. përfaqësues ligjor i subjektit "A. M." sh.p.k.
3. F. B., përfaqësues ligjor i subjektit "H. & S." sh.p.k.
4. L. V. nën cilësinë e kolaudatores së punimeve.

2.BASHKIALEZHË:

- Nga verifikimi rezulton se: KLSH-ja ka dërguar në Bashkinë Lezhë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 249/10, datë 30.06.2018, protokolluar në Bashkinë Lezhë me shkresën nr. 1839/40 datë 10.07.2017, ndërsa nga Bashkia Lezhë për zbatim e rekomandimeve të KLSH-së është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 1839/58, datë 17.07.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 250/6 datë 20.07.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes.

- Nga verifikimi rezulton se: Përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar "Bashkia Lezhë", me shkresën e Kryetarit të KLSH-së nr. 249/10, datë 10.06.2018 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 10.01.2019 (referuar nenit 33 pika 2 e ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2018 "Për funksionimin dhe organizimin e KLSH-së, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të rekomandimeve të pranuar, por nuk ka raportuar.

-B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 germa (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", nga Titullari i njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,547,953 lekë**.

Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 4 masa me vlerë 2.403,953 lekë, është pranuar dhe kontabilizuar e gjithë vlera dhe deri me datë 31.01.2019 janë arkëtuar 49,000 lekë, kanë mbetur në proces zbatimi 4 masa shpërblim dëmi 2,354,953 lekë.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga vlera e rekomanduar nga KLSH-ja prej.... **2,547,953lekë**.

-Deri më datën 20.09.2018 është arkëtuar.....49,000 lekë.

Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej2,498,953 lekë.

Nga të cilat: - 4 rekomandime janë nisur shkresat dhe nuk janë arkëtuar....2,498,953lekë.

Për zbatimin e plotë të rekomandimeve me dëm ekonomik, KLSH i rikërkon Bashkisë Lezhë shpërblimin e dëmit ekonomik si më poshtë:

1.1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës së prokurimit me objekt: "Rehabilitim i pjesshëm sipas projekteve "Skema ujitëse Mat-Lezhë, kanal sekondar", "Skemë shpërndarje rrjeti II Kotërr-Rraboshte dhe "Sistemi i shpërndarjes i rezervuarit Kallmet dhe Fishtë", konstatohet se fondi limit i hartuar nga shoqëria "A." & "E.G" me ing. B. H. për vlerën e projektit prej 56,500,000 lekë është rënduar për vlerën 235,410 lekë, pasi disa zëra të analizës së çmimeve nuk janë sipas çmimeve të manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015, duke rënduar padrejtësisht buxhetin e Bashkisë Lezhë (Trajtuar më hollësisht në pikën III/4, faqet 65-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.1. Rekomandimi: Bashkia Lezhë, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratave dhe arkëtimin e vlerës **235,410 lekë** nga shoqëria "A." & "E.-G" me ing. B. H..

Menjëherë

2.2. Gjetje nga auditimi: Në kontratën nr. 6872/2, datë 25.8.2017 në tenderi me objekti: “*Blerjen e dy mjeteve (kamion vetëshkarkues dhe kamion me vinç vetëshkarkues*”, afati për kryerjen e furnizimit të mallit është 15 ditë kalendrike, nga data e nënshkrimit të kontratës. Me datë 20.10.2017 shoqëria “L.” ka dorëzuar mallin ose 50 ditë vonesë.

Ndaj subjektit nuk është llogaritur penaliteti për mos dorëzim të mallit në afatin e përcaktuar në kontratë në vlerën **744,000 lekë**, veprime në dëm të buxhetit të Bashkisë Lezhë (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/4, faqet 65-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.2.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **744,000 lekë** nga subjekti “L.”.

Menjëherë

3.3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt “*Ndërtim ujësjellësi fshati Troshan*” Bashkia Lezhë, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Lezhë dhe shoqërisë “A.” SHPK, u konstatua se rezultojnë diferenca në volume për punime të pakryera inxhinierike duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë në vlerën **1,210,543 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/4.1, faqet 110-116, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.3.1. Rekomandimi. Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim e Zhvillim Territorit dhe atë juridike, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **1,210,543 lekë** nga subjekti “A.” SHPK, për diferenca në volume për punime të pakryera inxhinierike në zbatimin e kontratës “*Ndërtim ujësjellësi fshati Troshan, Bashkia Lezhë*”.

Menjëherë

4.4. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e blloqeve të gjobave të Policisë Bashkiake, konstatohet se në dy raste blloqet nuk janë dorëzuar nga personat përgjegjës. Nga Zyra e Financës Bashkia Lezhë ndaj këtyre 2 punonjësve të Policë Bashkiake është mbajtur procesverbali për humbjen e blloqeve të gjobave për vlerën 5,000 lekë/fleta, për vlerën totale prej 214,000 lekë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1497, datë 19.11.2008 “Për shtypjen e letrave me vlerë”, i ndryshuar me VKM nr. 277, datë 06.04.2011 dhe VKM nr. 393, datë 18.06.2014 dhe UNF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve të njësisë së sektorit publik”, kreu III, pikat 61 deri 72.

Gjithashtu konstatohet se nga gjobat e aplikuara nuk është bërë i mundur arkëtimi i vlerës së gjobave të mbetura në vlerën 144,000 lekë për 134 raste, në kundërshtim me kërkesat e nenit 20 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/5.2, faqet 123-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.4.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Lezhë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së gjobave të mbetura në vlerën **144,000 lekë për 134 raste**, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” nenet 20, 30, sipas pasqyrave Aneks 5/2a dhe b, bashkëlidhur Raport Auditimit.

4.4.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Lezhë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së gjobave të mbetura në vlerën **214,000 lekë**, respektivisht;

-**vlera 165,000 lekë**, në ngarkim të z. T. N., dhe

-**vlera 49,000 lekë**, në ngarkim të z. L. P. me detyrë polic i Policisë Bashkiake Lezhë.

Menjëherë

B.III MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA) në shumën

54,153,163 leke, për të cilën KLSH, rikërkon zbatimin e procedurave ligjore dhe ndjekjen e të gjithave shkallëve të gjykimit për arkëtimin e shumës 54,153,163 leke, si më poshtë:

- 15,609,000 lekë nga subjekti “Ü. L.” SHPK, mos pagese e taksës ndikimit infrastrukture

-9,747,743 lekë nga subjekti “A. V. K.” SHPK, për mos pagesën e taksës

-8,919,997 lekë nga 29 subjektet për dhënie me qira të hapësirës së plazhit për vitet 2016-2017

-305,415 lekë nga shoqëria “S.P.E. Gj.” SHPK, për zënie hapësirë publike sip pyjore

-108,000 lekë nga subjekti “Z. K.”; për per zenie hapësirë publike sip pyjore

-22,140 lekë nga subjekti “Gj. M.”, për zenie hapësirë publike sip pyjore

-9,230,000 lekë, gjobë nga IMTV ndaj subjektit “I. A.” vendodhja Njesia Administrative Shënkollë me pronar z. F. B.

-7,168,388 lekë nga subjekti “G.” SHPK përfaqësuar nga A. N., që rrjedhin nga kontrata e qirasë nr. 4123 datë 11.12.2014. për dhënien me qira të objektit “Tregu Rajonal Agro-Ushqimor” me sipërfaqe ndërtese 1364 m² dhe sipërfaqe trualli 6046 m² dhe afat përdorimi për një periudhë 20-vjeçare.

-3,042,480 lekë, Ish-Komuna Kolsh, sot Njesia Administrative Kolsh Bashkia Lezhë, gjatë viteve 2010, 2011 dhe 2013 ka lidhur kontrata pa vlerë me 38 persona për sipërfaqen 86.92 ha, me afat 10 vjeçare, për përmirësimin e fondit pyjorë dhe plotësimin e nevojave vetjake me material drusorë dhe prodhime të tjera, detyrimi i llogaritur dhe i papaguar për periudhën objekt auditimi (viti 2016 dhe 2017)

Për të cilën KLSH, kërkon zbatimin e procedurave ligjore dhe ndjekjen e të gjithave shkallëve të gjykimit për arkëtimin e shumës.

Të detajuara si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme në bashkinë Lezhë, rezulton se janë kryer kontabilizimet, por deri me date e verifikimit zbatimit rekomandimeve 22.02.2019 nuk është arkëtuar nga 2 subjekte ndërtues taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën **25,356,743 lekë e cila përbehet (15,609,000 + 9,747,743) konkretisht:**

a- Në lejen zhvillimore “*Godinë Banimi dhe Shërbimi 1-10 kate + 1 kat Podrum (Seksioni B-1)*” Bashkia Lezhë, nga auditimi i dokumentacionit teknik mbi llogaritjen e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezulton se kjo është paguar pjesërisht ose nuk është paguar vlera 12,247,743 lekë dëm ekonomik, në kundërshtim me ligjin nr. 107/204 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, neni 46, pika 2.

b- Nga auditimi rezulton se nuk është zbatuar rekomandimi dërguar me shkresën nr. 438/6, datë 13.09.2013 të KLSH, për masa shpërbllim dëmi në vlerën **15,609,000 lekë** nga subjekti “Ü.L” SHPK, për mos pagesën e taksës së ndikimit të infrastrukturë dhe penalitete (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/1, faqet 11-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi për gjetjet 1 dhe 2: Për të cilën KLSH, rikërkon zbatimin e procedurave ligjore dhe ndjekjen e të gjithave shkallëve të gjykimit për arkëtimin e shumave si më poshtë:

a. Bashkia Lezhë të marrë masa të kryejë kontabilizimin dhe të kërkojë në rrugë gjyqësore shpërbllimin e dëmit ekonomik në vlerën **15,609,000 lekë** nga subjekti “Ü.L.” SHPK, për mos pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe penalitete.

b. Bashkia Lezhë të marrë masa të kryejë kontabilizimin dhe të kërkojë në rrugë gjyqësore shpërbllimin e dëmit ekonomik në vlerën **9,747,743 lekë** nga subjekti “A. V. K.” SHPK, për mos pagesën e taksës së ndikimit të infrastrukturë. (Pasi nga shuma e rekomanduare prej **12,247,743 lekë** deri më datën 20.04.2018 është arkëtuar shuma prej 2,500,000 lekë duke mbetur për tu arkëtuar edhe shuma prej **9,747,743 lekë**),

c. Bashkia Lezhë, Drejtoria e Planifikimit Territorit, Drejtoria e Të ardhurave dhe Drejtoria e Financës për mos pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga 2 subjektet respektivisht: nga subjekti “Ü. L.” SHPK për vlerën **15,609,000 lekë** dhe subjekti “A. V. K.” SHPK për vlerën e mbetur prej **9,747,743 lekë**, të nxjerrin Njoftim vlerësimet përkatëse dhe të ndjekin procedurat e mëposhtme:

- a. T'i dërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
- b. T'i dërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".
- c. Në se 2 subjektet e mësipërme nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Bashkisë Lezhë (Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria Juridike), bazuar në pikën 1, neni 114 -Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat tatimore në R.SH" të ndryshuar, me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014, pasi të merren masat administrative duke i ngarkuar me një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, por jo më tepër se 365 ditë, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,-Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

Menjëherë

3.BASHKIALEZHË ish –Komunat:

- Nga verifikimi rezulton se: KLSH ka dërguar në Bashkinë Lezhë ish - Komunat rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.250/8, datë 19.06.2018, protokolluar në Bashkinë Lezhë me shkresën nr.1840/56, datë 21.06.2018, ndërsa nga Bashkia Lezhë për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.1840/57 datë 05/07/2018 protokolluar në KLSH me shkresën nr.250/15, datë 11.07.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Lezhë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.250/8, datë 19.06.2018 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 19.12.2018 (referuar nenit 33, pika 2 e ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2018 "Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA), por nuk është raportuar.

-B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 gërma (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", nga Titullari i njësisë publike, Bashkisë Lezhërikërkohen të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimine dëmit në **vlerën 24,319,418 lekë**, si më poshtë:*

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit në **ish- Komunën Kolsh**, konstatohet se me datë 18.04.2013 është lidhur kontratë ndërmjet ish- Komunës Kolsh përfaqësuar nga z. F. N. në cilësinë e Kryetarit të Komunës nga njëra anë dhe z. L. N. përfaqësues i firmës "N.", për dhënien me qira të objektit "*Tregu Rajonal Blegtoral Bujqësor*" me sipërfaqe ndërtese 1097 m² dhe sipërfaqe trualli 1950 m², për vlerën e qirasë mujore 154,816 lekë/ muaj. Nga subjekti "N.", deri në lidhjen e kontratës tjetër datë 02.07.2014, është likuiduar vlera 1,548,160 lekë, me një diferencë në vlerën **681,184 lekë**.

Me datë 02.07.2014 është lidhur kontrata e dytë e qirasë ndërmjet ish- Komunës Kolsh përfaqësuar nga z. F. N. me detyrë Kryetar i Komunës nga njëra anë dhe shoqërisë "G." SHPK, për dhënien me

qira të objektit “Tregu Rajonal Blegtoral Bujqësor” me sipërfaqe ndërtese 1364 m² dhe sipërfaqe funksionale 6046 m², për vlerën e qirasë mujore 262,578 lekë/muaj, në zbatim të VKM nr. 529, datë 08.06.2011. Nga subjekti “G.” deri me datë 15.06.2015 është likuiduar vlera prej 2,761,842 lekë, me një diferencë në vlerën **389,094 lekë**.

Gjithsej sipas kontratave të mësipërme për objektin “Tregu Rajonal Blegtoral Bujqësor” mbetet për arkëtim vlera **1,070,278 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur me dëm në buxhetin e ish- Komunës Kolsh (*Trajtuar hollësisht në pikën III/1, faqet 7-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,070,278 lekë**, *respektivisht:*

- vlera **681,184 lekë** nga subjekti “N.” SHPK.

- vlera **389,094 lekë** nga subjekti “G.” SHPK.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e veprimeve me arkën në ish- **Komunën Zejmen** për periudhën 01.01.2013 – 31.07.2015, u konstatuan parregullsi në veprimet e pagesës, konkretisht: Për vitin 2013, janë prerë 69 “Urdhër Pagesa”, me vlerë totale **719,700 lekë** me përshkrimin “Blerje me lekë në dorë”, për vitin 2014, janë prerë 82 “Urdhër Pagesa”, me vlerë totale **635,000 lekë** me përshkrimin “Blerje me lekë në dorë” dhe për vitin 2015 janë prerë 76 “Urdhër Pagesa”, me vlerë totale **609,600 lekë** me përshkrimin “Blerje me lekë në dorë”.

Në total për të tre vitet janë prerë gjithsej 227 copë “Urdhër Pagesa” me vlerë **1,964,300 lekë**, tërhequr nga ish- Kryetari i Komunës z. A. D., për të cilën nuk disponon asnjë dokumentacion ligjor justifikues mbi mënyrën e përdorimit të këtyre vlerave, veprime në shkelje të disiplinës financiare me **dëm ekonomik në vlerën 1,964,300 lekë**, në kundërshtim me UKM nr. 2 datë 13.05.2005, Kreu I pikën 3.1 dhe 8.3; të ligjit nr. 10296, date 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26, neni 9/4, neni 12/3; me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” pika 35,36,37,38, 42,43 dhe 44,52,54. (*Trajtuar hollësisht në pikën III/1, faqet 4-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Lezhë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,964,300 lekë**, *respektivisht:*

- vlera **982,150 lekë** nga z. A. D. me detyrë ish- Kryetar i Komunës Zejmen;

- vlera **982,150 lekë** nga z. V. B. me detyrë ish- Përgjegjës i Zyrës së Financës;

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e shpenzimeve për blerje me vlera të vogla për periudhën 01.01.2013 – 31.07.2015 të kryera në ish- **Komunën Zejmen**, konstatohet se në **8 raste me vlerë 1,452,200 lekë**, veprime janë në shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik, pasi në të gjitha rastet shpenzimet e kryera (*blerje me vlera të vogla*), nuk janë të shoqëruar me dokumentacion mbështetës dhe justifikues, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 1, neni 3/9, nenin 11, neni 23/4; me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik” neni 40 dhe neni 60-61; me UKM nr. 2 datë 13.05.2005, Kreu I pikën 3.1 dhe 8.3; të ligjit nr. 10296, date 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26, neni 9/4, neni 12/3; me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” pika 35,36,37,38, 42,43 dhe 44,52,54; Urdhër MF nr. 57, datë 12.06.2014 “Për Gjurmët standarde të Auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”; me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me UMF nr. 2 datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 98, *respektivisht:*

Për vitin 2013 janë 5 raste me vlerë 978,500 lekë, për vitin 2014 janë 2 raste me vlerë 233,700 lekë dhe për vitin 2015 (*periudha e gjashtë mujorit të parë*), është një rast me vlerë 60,000 lekë (*Trajtuar hollësisht në pikën III/1, faqet 7-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Lezhë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,452,200 lekë**, *respektivisht:*

- vlera **363,050 lekë** nga z. A. D. me detyrë ish- Kryetar i Komunës Zejmen, në cilësinë e Titullarit të AK;

-vlera **363,050 lekë** nga z. V. B. me detyrë ish- Përgjegjëse e Zyrës së Financës, në cilësinë e Kryetarit të KBVV.

-vlera **363,050 lekë** nga z. E. M. me detyrë ish- Sekretar i Këshillit të Komunës Zejmen, në cilësinë e Kryetarit të KBVV

-vlera **363,050 lekë** nga z. P. L. me detyrë ish- Inspektor i Taksave e Tarifave Vendore, në cilësinë e Kryetarit të KBVV.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt: “Asfaltim i rrugës rrotonte ishull Shëngjin – Stom” ish- Komuna Shëngjin, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Komuna Shëngjin dhe shoqërisë “K.” SHPK, rezultojnë diferenca në volume për punime inxhinierie të pakryera, duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë në vlerën **560,448 lekë** (*Trajtuar hollësisht në pikën III/2.1, faqet 88-91, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, bashkia Lezhë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **560,448 lekë** nga shoqëria “K.” SHPK, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Asfaltim i rrugës rrotonte ishull Shëngjin -Stom”.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në ish- Komunën Ungrej, me datë 17.11.2013 është lidhur kontratë qiraje midis ish- Kryetarit të Komunës z. Gj. Gj. nga njëra anë dhe znj. V. N. (kontratë Tip) “Për dhënie e tokës bujqësore të pandarë, pasuri e Komunës Ungrej” me sipërfaqe **12.8 ha**, në ZK 2109, e ndodhur në pasurinë nr. 169,166, 162/2-B, 159/1-B, 158/2-B, 165, 167/1-B, 162/1-B, Indeksi i hartës K-34-76-(75-A), Fshati Kashnjet, sipas vendimit të KK nr. 01, datë 15.11.2013 “Për dhënie me qira të tokave Bujqësore të pandara”. Kohëzgjatja e kësaj kontrata është për 99 vjet me vlerë 79,460 lekë/viti.

Pasuria është objekt i ligjit nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, VKM nr. 531, datë 21.08.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, i ndryshuar, UKM nr 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, UMB nr. 10, datë 13.09.2012 “Për mënyrën e përllogaritjes së kriterëve të vlerësimit të ofertave për marrjen me qira të tokës bujqësore, të pandarë”.

Nga ana e qiramarrësi zj. V. N., nga vlera e detyrimit për pagesë prej 317,840 lekë është likuiduar vlera 39,866 lekë (bankën Credins, sipas mandat pagesës datë 31.03.2015), dhe mbetet për pagesë vlera **277,974 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e ish- Komunës Ungrej (*Trajtuar hollësisht në pikën III/4, faqet 118-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Aseteve Bashkia Lezhë dhe Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **277,974 lekë nga zj. V. N.**

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit të tenderi me objekt: “Ndërtim ujësjellësi në fshatin Troshan” të zhvilluar në ish- Komunën Blinisht, konstatohet se fondit limit prej 83,146,690 lekë nuk është preventivuar sipas çmimeve të manualit teknik të miratuara në VKM nr. 568, datë 27.06.2013 “Për miratimin e manualeve teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike”, me ndryshime, pasi disa zëra çmimet e preventivuar nuk janë sipas manualit, duke rënduar padrejtësisht fondin limit për vlerën **3,615,615 lekë, dëm ekonomik** në ish- buxhetin e Komunës Blinisht (*Trajtuar hollësisht në pikën III/2, faqet 47-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Lezhë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **3,615,615 lekë**, nga personi përgjegjës për hartimin e preventivit **ing. z.M. P.**

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës së prokurimit me objekt: “*Ndërtim ujësjellësi në fshatin Troshan*” të zhvilluar në **ish- Komunën Blinisht**, me fond limit 83,146,690 lekë, konstatohet se operatori i shpallur fitues “A.” me ofertë 82,946,690 lekë, nuk plotëson kriteret e DST, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, si: -*Xhiros e deklaruar sipas vërtetimit të lëshuar nga Administrata Tatimore nuk përputhet me xhiros e deklaruar në pasqyrat financiare të viteve respektive;* - *Nuk paraqet punime të ngjashme;*-*Nuk ka deklaruar me deklaratë se kush është drejtuesi teknik.*

Gjithashtu nga verifikimi, konstatohet se KVO ka skualifikuar padrejtësisht shoqërinë “Gj. K.” me ofertë 69,920,900 lekë ose më e ulët se operatori fitues për vlerën 13,025,790 lekë, veprime me efekt negativ në përdorimin e fondit të prokuruar dëm ekonomi për **vlerën 13,025,790 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1- “*Objekti dhe qëllimi*” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2- “*Parimet e përzgjedhjes*” germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55 (*Trajtuar hollësisht në pikën III/2, faqet 47-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Shuma prej 13,025,790 lekë, të llogaritur si diferencë nga oferta e OE, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “*Objekti dhe qëllimi*” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “*Parimet e përzgjedhjes*” germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, **veprime të cilat ngarkojnë me dëm ekonomik secili nga 2,605,158 lekë (13,025,790: 5), pesë anëtarët e KVO si më poshtë:**

- 1.z. N. K. me detyrë Sekretar i këshillit
- 2.zj. F. M. me detyrë specialiste në zyrën e tatime NJA Blinisht,
3. z. S. L. me detyrë Administrator NJA Blinisht,
- 4.z. E. O. me detyrë ish- arkivist,
- 5.z. N. Ll. me detyrë spec pyjesh në NJA Blinisht.

7.1. Rekomandimi: Bashkia Lezhë të marrë masat të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet dhe arsyet për dëmin ekonomik të shkaktuar deri në arkëtimin e vlerës **13,025,790 lekë**, për kualifikimin e padrejtë të OE “A.”, i cili nuk përmbush kriteret për kualifikim.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës së prokurimit me objekt: “*Ndërtim ure auto 2HD, 10 m mbi përroin e Kalivaçit*”, në **ish- Komunën Ungrej**, konstatohet se shoqëria “A.” është tërhequr nga konkurrimi me pretendimin se nuk plotësonte nenin 9 të kontratës, ku thuhet se “*Pagesa sipas grafikut është 20% e pagesës në momentin e marrjes në dorëzim të objektit dhe pjesa tjetër pas çeljes së fondeve*”.

Argumenti i përdorur nga shoqëria ‘A.’, nuk është bindës dhe argumentues, pasi operatorët pjesëmarrës janë njohur me kushtet e kontratës, përpara se të zhvillohej procedura sipas kontratës së paraqitur në DST. Kështu ndaj subjektit “A.” duhej bërë sekuestrimi i sigurimit të ofertës në vlerën **201,705 lekë** bërë në shoqërinë “S.” me ref 56220-03-23-2012, datë 18.4.2012, vlerë e cila konsiderohet dëm ekonomik (*Trajtuar hollësisht në pikën III/2, faqet 84-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Lezhë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **201,705 lekë**, nga shoqëria “A.” SHPK.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës së prokurimit me objekt: “*Ndërtim ure auto 2HD, 10 m mbi përroin e Kalivaçit*”, në **ish- Komunën Ungrej**, konstatohet se shoqëria “G.” me ofertë 7,630,500 lekë është skualifikuar padrejtësisht nga KVO, me pretendimin se është ofertë anomalisht e ulët. Nga verifikimi i ofertave të paraqitur nga operatorët pjesëmarrës, konstatohet se

oferta e shoqërisë “G.” nuk është anomalisht e ulët, veprime me efekt negativ në përdorimin e fondit të prokuruar me dëm ekonomik në vlerën **1,959,960 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1-“*Objekti dhe qëllimi*” pika 2, gërma (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2- “*Parimet e përzgjedhjes*” gërma (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55 (*Trajtuar hollësisht në pikën III/2, faqet 84-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*) .

9.1. Rekomandimi: Bashkia Lezhë të marrë masat të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet dhe arsyet për dëmin ekonomik të shkaktuar deri në arkëtimin e vlerës **1,959,960 lekë**, për skualifikimin e padrejtë të OE “G.”.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës së prokurimit me objekt: “*Rikonstruksion i rrugës së shkollës Kallmet i madh (faza I)*” të zhvilluar në **ish- Komunën Kallmet**, me fond limit 2,266,224 lekë dhe fitues shoqërinë “O.” me ofertë 2,191,150 lekë, konstatohet se operatori i shpallur fitues (O.), nuk plotëson kriteret e DST të vendosura nga AK, pasi ka mangësi, si: -*Licenca e shoqërisë me nr. NZ 1367/4, datë 5.5.2008 dhe afat vlefshmërie 05.05.2019 (5 vjet), nuk ka kategorinë e punimeve NP-9A, pika 4.7/c e DST; -Nuk disponon mjet “FADROM” dhe “Makineri për prerje asfalti”, veprime me efekt negativ në përdorimin e fondit të prokuruar me dëm ekonomik 191,148lekë*, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1-“*Objekti dhe qëllimi*” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2-“*Parimet e përzgjedhjes*” germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55 (*Trajtuar hollësisht në pikën III/2, faqet 64-70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*) .

10.1. Rekomandimi: Bashkia Lezhë të marrë masat të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet dhe arsyet për dëmin ekonomik të shkaktuar deri në arkëtimin e vlerës **191,148lekë**, për kualifikimin e padrejtë të OE “O.”, pasi nuk plotëson kriteret e DST.

Menjëherë

4.BASHKIALUSHNJE:

-Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Lushnjë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.244/10, datë 29.06.2018, protokolluar në Bashkinë Lushnjë me shkresën nr. 4642, datë 08.07.2018, ndërsa nga Bashkia Lushnjë për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje pas 3 ditëve konkretisht me shkresën e saj nr. 4940, datë 11.07.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr.244/20, datë 11.07.2018.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Lushnjë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 244/10, datë 29.06.2018,dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ,ose brenda datës 29.12.2018, ndërkohë nga ana e KLSH është dërguar shkresa nr. 1337/4, datë 04.12.2018, e cila njofton për realizimin e një verifikimi në lidhje me zbatimin e detyrave të lëna,por nuk ka raportuar me shkrim në KLSH brenda afatit 6 mujor.

-A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Lushnjë 12 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 4 masa, janë në proces zbatimi 7 masa dhe ka 1 masë organizative të pa zbatuar dhe konkretisht Rekomandimi nr. 8 për të cilën rikërkojmë zbatimin e masës si vijon:

1.8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i funksionimit të organizimit të Policisë Bashkiake rezultoi se nuk ka gjetur zbatim kërkesa e pikës 2 të VKM nr. 1497, datë 19.11.2008, “*Letra me vlerë*” i ndryshuar, në administrimin dhe dokumentimin e gjobave (*Më hollësisht trajtuar në pikën A, në faqet 17 -74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.8.1 Rekomandimi:Nga Drejtoria e Financës dhe Policia Bashkiake të merren masat për dokumentimin dhe arkëtimin e gjobave sipas kërkesave të pikës 2 të VKM nr. 1497, datë 19.11.2008, “*Letra me vlerë*” i ndryshuar.

Menjëherë

5.BASHKIAMALLAKASTËR:

-Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Mallakastër rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.246.7, datë 30.06.2018, protokolluar në Bashkinë Mallakastër me shkresën nr. 576/25, datë 05/07/2018, ndërsa nga Bashkia Mallakastër për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.576/27 datë 24.7.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 246/11 datë 26.07.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Mallakastër.

-Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Mallakastër, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.246/8, datë 03.07.2018 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 03.01.2019,por nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brënda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA)

Nga Bashkia Mallakastër është përgatitur dhe dërguar pranë KLSH, Raport me shkrim “Mbi zbatimin e rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH”, e protokolluar me shkresën nr. 576/27, datë 24/07/2018, ku është raportuar brenda afatit.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Mallakastër 10 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 6 masa, janë në proces zbatimi 4 masa, për të cilat KLSH rikërkon zbatimin e plotë të tyre si më poshtë:

1.3. Gjetje nga auditimi: Nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Mallakastër, nuk është vepruar për të arkëtuar vlerën e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në ndërtimet pa leje ndërtimi, për arkëtimin e tyre, nuk është ndjekur rruga ligjore me padi në gjykatë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” nenet 20, 30 dhe të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar,**me efekt financiar negativ, të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, në vlerën 50,000 lekë, për 1 rast (Trajtuar në faqet 110-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

1.3.1. Rekomandimi: Bashkia Mallakastër, Zyra e IVMT, të marrë masa dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore deri në padi në gjykatë, për arkëtimin e gjobave të pa arkëtuara **në vlerën 50,000 lekë**, për 1 subjekt, për shkeljet e konstatuara në kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Menjëherë

2.4. Gjetje nga auditimi: Nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet e KLSH, dërguar me shkresën nr. 1113/128, datë 31.01.2017, protokolluar në subjekt me shkresën nr. 226, datë 06.02.2017 ku, nga **17** masa organizative të rekomanduara, janë pa zbatuar plotësisht **7** masa; nga 14 masa për shpërbllim dëmi është bërë kontabilizimi për vlerën 48,730,994 lekë, për të cilat janë nxjerrë urdhër njoftimet. Nga 14 masa shpërbllim dëmi në total, 8 masa për vlerën 1,912,345 lekë janë në proces zbatimi pasi janë arkëtuar pjesërisht, 6 masa janë në proces gjyqësor për vlerën 46,069,502, 1 masë në vlerën 35,400 është zbatuar plotësisht, 1 masë në vlerën 17,747 lekë është e pa zbatuar. Masat Disiplinore janë zbatuar plotësisht. Masat administrative për 5 persona janë në proces (Trajtar në faqet 116-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.4.1 Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë dhe Zyra Juridike, bashkia Mallakastër të marren të gjitha masat duke ndjekur të gjitha shkallët gjyqësore për arkëtimin e dëmit të shkaktuar buxhetit të shtetit të konstatuar nga auditimi i mëparshëm i KLSH, **në vlerën 46,695,594 lekë (Trajtar në faqet 116-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

Menjëherë

3.7. Gjetje nga auditimi: Bashkia Mallakastër nuk ka funksionuar në bazë strategjish periodike dhe objektiva prioritar. Nga auditimi dhe komunikimi me subjektin rezulton se për periudhën objekt i auditimit në Bashkinë Mallakastër nuk janë parashikuar plane vjetore dhe operacionale aktivitetesh

për realizimin e objektivave por ndjekja e realizimit të detyrave dhe përgjegjësive të përshkuara në rregulloren e brendshme si dhe monitorimi e raportimi funksionojnë në mënyrë operative si dhe nuk ka aplikuar metodën e vlerësimit dhe menaxhimit të risqeve që kërcënojnë realizimin e objektivave dhe respektivisht realizimin e funksioneve kryesore të ngarkuara sipas kuadrit rregullator në fuqi. Nga auditimi i evidencës së grumbulluar, raportimet e nivelit drejtues dhe përgjigjet e stafit të administratës në pyetësorët e aplikuar për këtë qëllim rezultojnë se nuk janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe veçanërisht në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm. *(Sa më sipër trajtuar në detaje në faqet nr. 17-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, në ushtrim të përgjegjshmërisë menaxheriale të institucionit që drejton, të formojë një grup pune me specialistë me njohuri të spikatura profesionale me qëllim që:

a) Të organizojë punën për vlerësimin e situatës aktuale të veprimtarisë së bashkisë identifikimin e dobësive, kërcënimeve dhe oportuniteteve dhe ndërtimin e strategjisë afatmesme e afatshkurtër të bashkisë duke marrë në konsideratë prioritetet e Bashkisë në vijimësi.

b) Pas përfshirjes në strategji të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve profesionale si objektiv prioritar, të vlerësojë nevojat për trajnime të stafit kryesisht në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe të hartojë plane vjetore dhe operacionale aktiviteteve për realizimin e objektivave në tërësi dhe ato në fushën e trajnimeve në veçanti.

3.7.2 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë nëpërmjet koordinatorit të riskut të ndërtojë një plan pune me detyra të mirë përcaktuara për të organizuar punën në bashki për aplikimin e funksionimit të institucionit me bazë vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në çdo nivel të administratës dhe dokumentimin në regjistrin qendror të riskut në vazhdimësi si rezultat i rishikimit dhe rivlerësimit të risqeve me qëllim garantimin e arsyeshmëri dhe në nivel sa më optimal të realizimit të objektivave dhe misionit të bashkisë.

Rekomandimet sa më sipër, në referencë të përcaktimeve në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, neni 8, pika 8; neni 10; neni 16; neni 21; dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010.

Menjëherë

4.10. Gjetje nga auditimi: Pranë sektorit të financës është caktuar një specialiste për asetet. Nga verifikimi rezultojnë se nuk është krijuar një database për pronat që me VKM respektive i kanë kaluar Bashkisë Mallakastër. Administrohen vetëm listat e pronave sipas VKM për ish-bashkinë dhe ish-komunat që janë shkrirë në Bashkinë Mallakastër pas reformës territoriale administrative. Ende nuk ka filluar regjistrimi i pronave në ZVRPP me argumentin se nevojiten fonde për regjistrim dhe kjo është në pamundësi të bashkisë për fondet në dispozicion për të mbuluar regjistrimin e tyre në ZVRPP si dhe për mosplotësim të kërkesave të bashkisë nga ZVRPP mbi statusin juridik të pronave që kanë kaluar bashkisë me VKM përkatëse. Rezultojnë gjithashtu se nuk është ndërmarrë nisma për vlerësimin e pronave dhe regjistrimin si angazhim në librat e llogarisë së institucionit. *(Sa më sipër trajtuar në detaje në faqet nr. 109-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.10.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër të marrë masa për krijimin e një sektori për menaxhimin dhe administrimin e pronave të bashkisë që me VKM kanë kaluar në pronësi apo përdorim me përbërje specialistë të fushës juridike dhe topografike me qëllim që të hartohen praktikat e aplikimit në ZVRPP për regjistrimin e pronave dhe ndjekjen e punës në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike për verifikimin dhe rivlerësimin kontabël të tyre duke siguruar kontrollin juridik dhe efektiv mbi pronat e bashkisë duke bërë të mundur mobilizimin e tyre për krijimin e të ardhurave nga dhënia me qira e pronave.

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE;

C. 1. Për Agjencinë e prokurimit publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit përfundimtar të auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH **i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me të metat e mangësitë e konstatuara, nga ku me shkresën nr. 8573/6, datë 17.01.2019 si dhe Vendimin nr. 5, datë 17.01.2019, APP ka vendosur të dënojë me gjobë 10 persona në shumën totale prej **2,250,000** lekë për të cilët kërkojmë nga Bashkia Mallakastër të merren të gjitha masa e nevojshme për arkëtimin e shumës nga personat përgjegjës si më poshtë:

1. **A. K.**, në masën 350,000 lekë;
2. **H. S.**, në masën 200,000 lekë;
3. **A. R.**, në masën 200,000 lekë;
4. **A. X.**, në masën 200,000 lekë;
5. **A. N.**, në masën 400,000 lekë;
6. **N. S.**, në masën 250,000 lekë;
7. **P. L.**, në masën 250,000 lekë;
8. **B. F.**, në masën 150,000 lekë;
9. **R. M.**, në masën 150,000 lekë;
10. **R. L.**, në masën 100,000 lekë.

Për gjobat e vendosura nga APP, me vendimin nr.5, datë 17.01.2019 nga Bashkia Mallakastër, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës të kontabilizohen vlera e vendimeve të gjobave të vendosura nga APP. Në rast mosarkëtimi nga ana e bashkisë të shumës së mësipërme, KLSH **kërkon** që të merren **masat e mëposhtme**:

a) Të marrë masa për dërgimin në Gjykatë dhe kthimin në tituj ekzekutiv, të vendimeve të gjobave të vendosura nga APP, sikurse parashikohet në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, konkretisht në nenin 24-*Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv*.

b) Të marë masa për llogaritjen e kamat vonesave për gjobat e vendosura nga APP, bazuar në ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, **neni 30-”Arkëtimi i shumave të detyrimeve”** ku parashikohet se: 3. Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë paguhet **kamat 2 për qind në muaj të masës gjobës**, me përjashtim të rasteve kur ligji i posaçëm parashikon përqindje të ndryshme për kamatë vonesat.

c. Kryetari i bashkisë, **të fillojë procedurat largimit nga puna**, ndaj personit përgjegjës i cili nuk ka nisur procedurat e nevojshme ligjore të vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të gjobës), bazuar në ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, pika 5) ku parashikohet se **-neni 44” Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”**, në rast se gjobat dhe detyrimet e tjera, të vendosura nga vendimi për kundërvajtjen administrative, nuk paguhen për mosveprim të punonjësit të organit administrativ, i cili ka miratuar vendimin përkatës dhe detyrimin që të kërkojë arkëtimin e shumave, apo për shkak se punonjësi nuk nis procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ, **atëherë ndaj tij fillojnë procedurat e largimit nga puna**.

d. Drejtoria Juridike, bazuar në nenet 151 dhe 152, të “Kodit Procedurës Civile në RSH”, të marrin masa dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për vendimet e dënimit me gjobë të vendosura nga APP, të cilave u ka kaluar afati ligjor 2 vjeçar, duke shtuar në kërkesat drejtuar Gjykatës edhe llogaritjen e kamat vonesave .

e) Bazuar në ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 4. Përgjegjësia për vjeljen e gjobave, të vendosura sipas pikës 1, të këtij neni, është e autoritetit kontraktor.

C. 2. Për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **KLSH i ka rekomanduar** Kryetarit të Bashkisë Mallakastër t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë për 1 mbikëqyrës punimesh dhe 1 kolaudator punimesh.

Nga verifikimi rezultoi se kryeinspektorit të inspektoratit të mbrojtjes së territorit ka nxjerë vendimet për dënim me gjobë për 2 persona në shumën **550,000 lekë**, por nuk ka filluar procesi i arkëtimit, si më poshtë:

1. E. M., nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve. Me vendimin e IMTV nr. 6, datë 17/09/2018 është gjobitur në shumën **50,000 lekë**.

2. G. S., nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve. Me vendimin e IMTV nr. 7, datë 20/09/2018 është gjobitur në shumën **500,000 lekë**.

Për gjobat e vendosura nga IMTV nga Bashkia Mallakastër, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës, KLSH rikërkon të kontabilizohen vlera e vendimeve të gjobave të vendosura nga IMTV në shumën prej 550,000 lekë dhe ndjekjen e procedurave ligjore nëpërmjet zyrës së përmbarimit etj, deri në arkëtimi e plotë të tyre.

6. BASHKIA KONISPOL:

-Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Konispol rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 247/7, datë 08.07.2018, protokolluar në Bashkinë Konispol me shkresën nr. 276/3, datë 13.07.2018, ndërsa nga Bashkia Konispol për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 276/6, datë 27.07.2018 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 247/12 datë 11.10.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes.

-Bashkia Konispol, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 247/7, datë 08.07.2018 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 08.01.2018 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA)

Nga Bashkia Konispol është përgatitur dhe dërguar pranë KLSH, Raport me shkrim “Mbi zbatimin e rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH”, e protokolluar me shkresën nr. 3552, datë 13.06.2018, ku është raportuar brenda afatit.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Konispol 14 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 12 masa, janë në proces zbatimi 2 masa, për të cilat KLSH rikërkon zbatimin e plotë të tyre si më poshtë:

1.7. Gjetje nga auditimi: a. Në Bashkinë Konispol, në fund të vitit 2017 rezultojnë debitorë për taksa dhe tarifa vendore 23 subjekte të biznesit të vogël, 1 subjekt i biznesit të madh dhe 607 familje, për të cilat llogaritet mungesë të ardhurash **në vlerën 14,837,000 lekë**.

b. Për detyrimet e pa paguar në afatet e përcaktuara në ligj dhe në Vendimet e Këshillit Bashkiak, nuk është llogaritur dhe as arkëtuar gjoba, kamat vonesat prej 0.06% për qind të shumës së detyrimit të papaguar, rezulton me mungesë të ardhurash **në vlerën 3,249,303 lekë**.

c. Mbi vjeljen e detyrime për tatim taksat lokale, konstatohet se nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI-Drejtoria e Sarandë, **në vlerën 399,814 lekë**. Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI i ka

dërguar Bashkisë Konispol, konstatohet se deri më 31.12.2017, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifën përkatëse 15 persona për sipërfaqe ndërtimore të legalizuara gjithsej 2,435 m², për banim dhe për aktivitet social ekonomik. Përsa më sipër, nuk janë zbatuar kërkesat e nenit 23 të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar dhe VKB nr. 3, datë 09.01.2017 “Për miratimin e taksave e tarifave vendore për vitin 2017”.

Po ashtu Zyra e Tatim Taksave Bashkia Konispol për arkëtimin e debitorëve të taksave vendore dhe taksës ndikimit në infrastrukturë, nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore, veprim jo në përputhje me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, nenet 40, 41 90, 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 dhe nenin 12, të UMF nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve” (*trajtuar më hollësisht në faqet 23-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.7.1. Rekomandimi: Zyra e Tatim Taksave në Bashkinë Konispol, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, të marrë masat për arkëtimin e detyrimeve tatimore duke bërë njoftim vlerësimet tatimore:

-për 23 subjekte të biznesit të vogël, 1 subjekt të biznesit të madh dhe 607 familje, debitorë ***në shumën 14,837,000 lekë*** dhe

-për 15 persona në vlerën totale të pa arkëtuar prej ***399,814 lekë, e ardhur e munguar*** nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore të legalizuara.

-për 24 subjekte dhe 607 familje në vlerën totale prej ***3,249,303 lekë, e ardhur e munguar*** nga llogaritja e kamat vonesave për detyrimet e papaguara në afat.

Duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a- Tu dërgohen bankave (subjekteve që nuk u është dërguar) urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

b- Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

c- Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 %, kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative, të bëhet kallëzim penal.

Menjëherë

2.12.Gjetje nga auditimi: Nuk ka kryer kolaudimin dhe vlerësimin e aseteve, nuk ka kryer inventarizimin kontabël dhe fizik të aseteve, nuk ka aplikuar në ZVRPP Sarandë për regjistrimin e aseteve, nuk ka hartuar përmbledhjen dhe bashkimin e listave të aseteve të dy Njësive Administrative ish-komunat, Markat dhe Xarrë, për të përpiluar në këtë mënyrë një pasqyrë të qartë të pasurive të paluajtshme të bashkisë, me qëllim inventarizimin, vlerësimin, administrimin, regjistrimin, kontabilizimin dhe dokumentimin në pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Konispol, veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu III, pika 1 (*trajtuar më hollësisht në faqet 93-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.12.1.Rekomandimi: Bashkia Konispol, të marrë masa për evidentimin e pronave të ish- Bashkisë Konispol dhe 2 Njësive Administrative, Xarrë dhe Markat, të kryej inventarizimin, vlerësimin, kontabilizimin, pasqyrimin në aktivet e qëndrueshme të pasqyrave financiare dhe të marrë masapër regjistrimin e të gjitha aseteve në ZVRPP Sarandë.

Menjëherë

7.BASHKIAKËLCYRË:

- Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Këlcyrë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 248/10, datë 29.06.2018, protokolluar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr.1364, datë 04.07.2018, ndërsa nga Bashkia Këlcyrë për zbatim e rekomandimeve të KLSH nuk është kthyer përgjigje brenda 20 ditëve

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Këlcyrë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.248/10, datë 29.06.2018 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 29.12.2018 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA)

Nga Bashkia Këlcyrë nuk është përgatitur dhe dërguar pranë KLSH, Raport me shkrim “Mbi zbatimin e rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH”.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Këlcyrë 14 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 5 masa, janë në proces zbatimi 6 masa për të cilat KLSH rikërkon zbatimin e plotë të 6 rekomandimeve në proces zbatimi respektivisht: 3.1; 4.1; 6.1; 7.1; 8.1; 9,1;11.1 dhe 3, ndërkohë për 3 masat organizative të cilat nuk janë zbatuar KLSH rikërkon zbatimin e plotë të tyre si më poshtë:

1.9. Gjetje nga auditim:Në Bashkinë Këlcyrë nuk është bërë emërimi i Kryeinspektorit të IMTV për periudhën 2016-2017, duke sjellë mosfunksionimin dhe mospërbushjen e detyrimeve ligjore mbi mbrojtjen e territorit, në kundërshtim me nenin 1, 2, 4, 11,12 dhe 13 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën D.1.5, faqe 108-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.9.1 Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë të marrë masa për plotësimin e strukturës së IMTV-së me Kryeinspektor me qëllim mbrojtjen e teritorit nga ndërtimet e paligjshme.

Menjëherë

2.10. Gjetje nga auditimi: Bashkia Këlcyrë, për të gjitha asetet nuk ka hapur regjistër kontabël, në kundërshtim me kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Po kështu në kundërshtim me pikën 31/d të udhëzimit të mësipërm, nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik (*Më hollësisht trajtuar në pikën D.1.5, faqe 108-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.10.1 Rekomandim: Bashkia Këlcyrë, pas azhurnimit të aseteve të kaluara në pronësi të saj me VKM nr. 114, datë 03.02.2008 dhe aplikimit për regjistrim në ZVRPP Përmet, të krijojë dhe mbajë regjistrin kontabël të tyre, si dhe regjistrin e pasurive të paluajtshme të dhëna me qira.

Menjëherë

A.2 . MASA ORGANIZATIVE NGA SHQYRTIMI I DENONCIMEVE TË BËRA NGA QYTETARËT

Bazuar në programin e auditimit, u mor në shqyrtim denoncimi i bërë nga qytetari A. B., protokolluar në KLSH me nr.345, datë 20.03.2018. Në lidhje me këtë çështje, nga grupi i auditimit është trajtuar një pjesë e problematikës së ngritur nga qytetari.

Nga auditimi i çështjeve të ngritura nga qytetari rezultuan gjetjet e mëposhtme:

2. Gjetje nga auditimi: Bazuar në informacionin e dhënë nga zyra e urbanistikës, për taksën e ndikimit në infrastrukturë gjendja progresive e debitorëve për këtë taksë është 1,770,523 lekë. Kjo vlerë nuk është kontabilizuar në pasqyrat financiare të Bashkisë, përfshin 29 subjekte private për periudhën 2010-2011 ka ardhur si rezultat i llogaritjes në detyrimin në vlerë më të vogël se përqindja

e miratuar nga Këshilli Bashkiak (*Më hollësisht trajtuar në pikën G, faqe 143-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marrë masa për arkëtimin e vlerës 1,770,523 lekë, si detyrim i pa likuiduar nga 29 subjekte private, për taksën e ndikimit në infrastrukturë, sipas listës në aneksin nr. 6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

B/1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në vlerën **38.657.994 lekë**. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën 38.657.994 lekë, si më poshtë:*

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej.....**38.657.994 lekë**
-Deri më datën 28.02.2019 është arkëtuar0 lekë
Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej..... **38.657.994 lekë**

Nga të cilat:

-Janë nisur njoftimet për 11 rekomandime por ende nuk kanë filluar arkëtimet... **38.657.994 lekë**

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt “Rijetëzimi i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin Qendër-Këlcyrë”, të lidhurndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkia Këlcyrë dhe BOE “S.” SHPK & “R.” SHPK u konstatua se për zërin “Furnizim vendosje hekur beton periodik Ø 6-10 mm” janë situacionuar 8.084 ton hekur me shumë nga sasia e preventivit aktual të ndryshuar dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë në vlerën **989,461 lekë me TVSH**(*Më hollësisht trajtuar në pikën C.1.4, faqe 91-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marrë masa që në situacionin përfundimtar të kontratës “Rijetëzimi i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin Qendër-Këlcyrë”, t’i zbrësë BOE “S.” SHPK & “R.” SHPK shumë prej **989,461 lekë me TVSH**, për volum punimesh të pa përfshira në preventivin e miratuar.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Rikualifikimi urban i përroit në lagjen Gur”, të lidhurndërmjet Autoritetit Kontraktor, Bashkia Këlcyrë dhe BOE “H. & E.” SHPK, u konstatua se nga autoriteti kontraktor nuk është mbajtur penalitet në vlerën prej **162,488 lekë me TVSH** ndaj kontraktorit, për shkelje të afateve kontraktuale, veprim në kundërshtim me nenin 5 dhe me nenin 33 germa (a) të kontratës (*Më hollësisht trajtuar në pikën C.1.4, faqe 91-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **162,488 lekë me TVSH** nga BOE “H.” SHPK & “E.” SHPK, si dëme të likuidueshme për shkelje të afateve të kontratës.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt “Rehabilitimi i kanalit Ballaban, krahu i majtë”, të lidhurndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkia Këlcyrë dhe Kontraktuesit BOE “2.” SHPK & “Sh.” SHPK, u konstatua se autoriteti kontraktor ka likuiduar më tepër për diferenca në volume të punimeve dhe për mos rakordim vlerash në situacionin

përfundimtar, vlerën **118,440 lekë lekë me TVSH, e cila përbën dëm ekonomik** për buxhetin e njësisë vendore (*Më hollësisht trajtuar në pikën C.1.4, faqe 91-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **118,440 lekë me TVSH** nga BOE “2.” SHPK & “Sh.” SHPK, për diferenca në volume punimesh të pakryera dhe mos rakordim vlerash në situacionin përfundimtar.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt "Rikonstruksion i rrugës Sukë - Zhepovë, Loti 1, zhvilluar në datën 22.02.2017, me fond limit 62,499,987 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “N.” SHPK & “R.” SHPK, me vlerë të ofertës 62,075,361 lekë, i cili nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të vendosura në DST dhe është s’kualifikuar operatori ekonomik “Boshnjaku B” SHPK prej 51,803,050 lekë pa TVSH i ndodhur në të njëjtat kushte. Nga KVO tenderi duhet të ishte anuluar, pasi asnjë ofertë nuk është e vlefshme. Mos kryerja e këtij veprimi ka shkaktuar dëm ekonomik në **vlerën 10,272,311 lekë**, si diferencë midis 2 ofertave të ndodhura në të njëjtat kushte, veprim në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika b, d, dh; nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika a, c;”, nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; 5; nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave: z. A. L., zj. R. H., z. A. Q. (*Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 55-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **10,272,311 lekë pa TVSH**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si më poshtë:

1- z. A. L. me detyrë specialist i kadastrës, për shumën **3,424,104 lekë**.

2- zj. R. H. me detyrë përgjegjëse e zyrës së taksave dhe tarifave vendore, për shumën **3,424,104 lekë**.

3- z. A. Q. me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore për shumën **3,424,104 lekë**.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt "Rrjetëzim i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin Qendër-Këlcyrë, zhvilluar në datën 27.06.2017, me vlerë të fondit limit 124,090,700 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “S.” SHPK & R.” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 123,985,927 lekë pa TVSH, i cili nuk i plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të vendosura në DST dhe është s’kualifikuar operatori ekonomik BOE “B.” SHPK & B.” SHPK me vlerë të ofertës ekonomike 114,804,173 lekë pa TVSH, i cili ndodhet në të njëjtat kushte plotësimi të kriterëve për kualifikim. Nga KVO tenderi duhet të ishte anuluar, pasi asnjë ofertë nuk është e vlefshme. Mos kryerja e këtij veprimi ka shkaktuar dëm ekonomik në **vlerën 9,181,754 lekë pa TVSH**, si diferencë midis 2 ofertave të ndodhura në të njëjtat kushte, veprim në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika b, d, dh; nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika a, c;”, nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; 5; nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave: z. A. L., zj. R. H., z. A. Q.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 62-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **9,181,754 lekë pa TVSH**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si më poshtë:

1.z. A. L. me detyrë specialist i kadastrës, për shumën **3,060,585 lekë**.

2.zj. R. H. me detyrë përgjegjëse e zyrës së taksave dhe tarifave vendore, për shumën **3,060,585 lekë**.

3. z. A. Q. me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore për shumën **3,060,585 lekë**.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Rikualifikimi i bllokut të banesave e fasadave në rrugën hyrëse”, me fond limit 58,676,804 lekë pa TVSH, zhvilluar në muajin nëntor 2016, është shpallur fitues BOE “L. K.” SHPK & “F.” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 58,510,833 lekë pa TVSH, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe, është s’kualifikuar padrejtësisht BOE “B. & P. V.” SHPK me vlerë të ofertës ekonomike 51,032,790 lekë pa TVSH, i cili plotëson kriteret e DST. Si rezultat i diferencës midis dy ofertave për buxhetin e njësisë vendore është krijuar **dëm ekonomik në vlerën 7,478,043 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika b, d, dh; nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika a, c; nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; 5; nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Ngarkohen me përgjegjësi komisioni i vlerësimit të ofertave: z. A. L., zj. R. H., z. A. Q. (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 45-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marr masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e shumës **7,478,043 lekë pa TVSH**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si më poshtë:

- 1- z. A. L., me detyrë specialist i kadastrës, për shumën **2,492,681 lekë**.
- 2- zj. R. H., me detyrë përgjegjëse e zyrës së taksave dhe tarifave vendore, për shumën **2,492,681 lekë**.
- 3- z. A. Q., me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore për shumën **2,492,681 lekë**.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt "Skema ujitëse Ballaban, (Ujitja e fushës Ballaban, vazhdim)", zhvilluar në datën 15.06.2017, me vlerë të fondit limit 20,833,333 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE "Sh," SHPK & "2." SHPK me vlerë të ofertës 20,796,724 lekë pa TVSH, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe është s’kualifikuar padrejtësisht operatori ekonomik “S. C.” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 16,248,932 lekë pa TVSH, i cili plotëson kriteret e DST. Si rezultat i diferencës midis dy ofertave është krijuar **dëm ekonomik në vlerën 4,547,729 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika b, d, dh; nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika a, c; nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; 5; nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Ngarkohen me përgjegjësi komisioni i vlerësimit të ofertave: z. A. L., zj. R. H., z. A. Q. (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 79-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marr masat dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **4,547,729 lekë pa TVSH**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si më poshtë:

- 1- z. A. L. me detyrë specialist i kadastrës, për shumën **1,515,930 lekë**.
- 2- zj. R. H. me detyrë përgjegjëse e zyrës së taksave dhe tarifave vendore, për shumën **1,515,930 lekë**.
- 3- z. A. Q. me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore për shumën **1,515,930 lekë**.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Rehabilitim i skemës ujitëse të rezervuarve Këlcyre dhe Varibop”, zhvilluar në datën 27.11.2017, me vlerë të fondit limit 16,005,490 lekë pa TVSH, kanë marrë pjesë 9 OE, nga të cilët është shpallur fitues BOE “E.” SHPK & “A. K.” SHPK, i renditur i nënti në radhë, me vlerë të ofertës ekonomike më të lartë prej 15,952,517 lekë, i cili nuk i plotëson kriteret për kualifikim të vendosura në DST dhe është s’kualifikuar padrejtësisht OE “N.” SHPK, me vlerë të ofertës 12,564,759 lekë pa TVSH, i cili i plotëson kriteret e kualifikimit të vendosura në DST. Si rezultat i diferencës midis dy ofertave është krijuar **dëm ekonomik në vlerën 3,387,758 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika b, d, dh; nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika a, c; nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; 5; nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Ngarkohen me përgjegjësi komisioni i vlerësimit të ofertave: z. A. L., zj. R. H., z. A. Q. (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 73-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e shumës **3,387,758 lekë pa TVSH**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si më poshtë:

1- z. A. L., me detyrë specialist i kadastrës, për shumën **1,129,253 lekë**.

2- zj. R. H., me detyrë përgjegjëse e zyrës së taksave dhe tarifave vendore, për shumën **1,129,253 lekë**.

3- z. A. Q., me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore për shumën **1,129,253 lekë**.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “Përmirësim kushte të banimit të komunitetit rom e egjiptian”, me fond limit 6,593,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2016, është shpallur fitues BOE “A. & E.” SHPK me vlerë të ofertës ekonomike 6,540,560 lekë pa TVSH dhe është s’kualifikuar padrejtësisht OE “F.” SHPK me vlerëtë ofertës ekonomike 4,972,324 lekë pa TVSH. Si rezultat i diferencës midis dy ofertave për njësinë vendore është krijuar **dëm ekonomik në vlerën 1,568,236 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika b, d, dh; nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika a, c; nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; 5; nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Ngarkohen me përgjegjësi komisioni i vlerësimit të ofertave: z. A. L., zj. R. H., z. A. Q. (*Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 50-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e shumës **1,568,236 lekë pa TVSH**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si më poshtë:

1- A. L. me detyrë specialist i kadastrës, për shumën **527,745 lekë**.

2- R. H. me detyrë përgjegjëse e zyrës së taksave dhe tarifave vendore, për shumën **527,745 lekë**.

3- A. Q. me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore për shumën **527,745 lekë**.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Shtrimi i pjesëve të vështira të rrugëve rurale dhe përmirësimi i këmbeve të urave me beton”, zhvilluar në datën 18.09.2017, me vlerë të fondit limit 14,166,666 lekë pa TVSH, kanë marrë pjesë 5 OE, nga të cilët është shpallur fitues BOE “A. & H.” SHPK me vlerë të ofertës 12,488,243 lekë, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe është s’kualifikuar padrejtësisht OE “E.” SHPK me vlerë të ofertës ekonomike 11,698,469 lekë pa TVSH, i cili i plotëson kriteret për kualifikim të vendosura në DST. Si rezultat i diferencës midis dy ofertave është krijuar **dëm ekonomik në vlerën 789,774 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika b, d, dh; nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika a, c; nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; 5; nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Ngarkohen me përgjegjësi komisioni i vlerësimit të ofertave: z. A. L., zj. R. H., z. A. Q. (*Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 82-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e shumës **789,774 lekë pa TVSH**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si më poshtë:

1- z. A. L. me detyrë specialist i kadastrës, për shumën **263,258 lekë**.

2- zj. R. H. me detyrë përgjegjëse e zyrës së taksave dhe tarifave vendore, për shumën **263,258 lekë**.

3- z. A. Q. me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore për shumën **263,258 lekë**.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Blerje automjete (fadromë, autoveturë, automjet vetëshkarkues)”, zhvilluar në muajin dhjetor 2016, përsëritur procedura 3 herë, në radhën e dytë të zhvillimit të procedurës është s’kualifikuar padrejtësisht OE “S.” SHPK me vlerë të ofertës ekonomike 5,188,000 lekë pa TVSH, i cili i plotëson kriteret e vendosura në DST. Në radhën e tretë të zhvillimit të procedurës “Me negociim pa shpallje paraprake të kontratës”, është rritur në mënyrë

të pa argumentuar fondi limit dhe është shpallur fitues operatori ekonomik "R." SHPK me vlerë të ofertës ekonomike 5,350,000 lekë. Si rezultat i s'kualifikimit padrejtësisht të OE "S." SHPK, është shkaktuar **dëm ekonomikë vlerën 162,000 lekë** ndaj buxhetit të njësisë vendore, si rezultat i diferencës midis dy ofertave. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 "Objekti dhe qëllimi", pika b, d, dh; nenin 2 "Parimet e përzgjedhjes", pika a, c; nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3; 5; nenin 55 "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese", të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Ngarkohen me përgjegjësi komisioni i vlerësimit të ofertave: z. A. L., z. F. L., z. A. Q. (*Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 40-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1-Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marr masat dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e shumës **162,000 lekë pa TVSH**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si më poshtë:

- 1- z. F. L., person i kontaktuar nga jashtë institucionit, për shumën **54,000 lekë**.
- 2- z. A. L. me detyrë specialist i kadastrës, për shumën **54,000 lekë**.
- 3- z. A. Q. me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore për shumën **54,000 lekë**.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE;

d.1.Mbi gjobat e rekomanduara Agjencisë prokurimit Publik.

I.Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2017, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", KLSH i ka **rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin e Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), ndaj 7 punonjësve.** Nga verifikimi rezultoi se APP me vendimin nr.109, datë 16.11.2018 percjellë në Bashkinë Këlcyrë dhe KLSH, me shkresën nr.9051/2 datë 16.11.2018, duke vendosur masa dënim me gjobë për 9 persona në vlerën në totale prej **1,400,000 lekë**. Nga Bashkia Këlcyrë janë njoftuar personat dhe janë kontabilizuar veprimet. Deri në momentin e verifikimit nuk është arkëtuar asnjë lekë, **për 9 personat si më poshtë:**

1. **M. M. (L.)**, me detyrë përgjegjëse e burimeve njerëzore. Me vendimin e APP nr 109, datë 16.11.2018 është gjobitur në shumën 100.000 lekë.
2. **S. V.**, me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore. Me vendimin e APP nr109, datë 16.11.2018 është gjobitur në shumën 100.000 lekë.
3. **A. L.**, me detyrë specialist i kadastrës, në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO). Me vendimin e APP nr 109, datë 16.11.2018 është gjobitur në shumën 300.000 lekë.
4. **R. H.**, me detyrë përgjegjëse e zyrës së taksave dhe tarifave vendore, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO). Me vendimin e APP nr109, datë 16.11.2018 është gjobitur në shumën 250.000 lekë.
5. **A. Q.**, me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO) Me vendimin e APP nr 109, datë 16.11.2018 është gjobitur në shumën 300.000 lekë.
- 6.**F. L.**, me vendimin e APP nr.109, datë 16.11.2018 është gjobitur në shumën 50.000 lekë.
- 7.**B. H.**, me vendimin e APP nr.109, datë 16.11.2018 është gjobitur në shumën 100.000 lekë.
- 8.**R. A.**, me vendimin e APP nr.109, datë 16.11.2018 është gjobitur në shumën 100.000 lekë.
- 9.**K. N.**, me vendimin e APP nr.109, datë 16.11.2018 është gjobitur në shumën 100.000 lekë.

Për gjobat e vendosura nga APP, me vendimin nr.109, datë 16.11.2018 nga Bashkia Këlcyrë, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës të kontabilizohen vlera e vendimeve të gjobave të vendosura nga APP, KLSH rikërkon Bashkisë **që të meren masat e mëposhtme:**

a) Të marrë masa për dërgimin në Gjykatë dhe kthimin në tituj ekzekutiv, të vendimeve të gjobave të vendosura nga APP, sikurse parashikohet në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, konkretisht në nenin 24-*Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv.*

b) Të marrë masa për llogaritjen e kamat vonesave për gjobat e vendosura nga APP, bazuar në ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, **neni 30-”Arkëtimi i shumave të detyrimeve”** ku parashikohet se: 3.Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë paguhet **kamat 2 për qind në muaj të masës gjobës**, me përjashtim të rasteve kur ligji i posaçëm parashikon përqindje të ndryshme për kamatëvonesat.

c. Kryetari i bashkisë, **të fillojë procedurata largimit nga puna**, ndaj personit përgjegjës i cili nuk ka nisur procedurat e nevojshme ligjore të vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të gjobës), bazuar në ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, pika 5) ku parashikohet se **-neni 44” Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”**, në rast se gjobat dhe detyrimet e tjera, të vendosura nga vendimi për kundërvajtjen administrative, nuk paguhen për mosveprim të punonjësit të organit administrativ, i cili ka miratuar vendimin përkatës dhe detyrimin që të kërkojë arkëtimin e shumave, apo për shkak se punonjësi nuk nis procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ, **atëherë ndaj tij fillojnë procedurat e largimit nga puna.**

d. Drejtoria Juridike, bazuar në nenet 151 dhe 152, të “Kodit Procedurës Civile në RSH”, të marrin masa dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për vendimet e dënimit me gjobë të vendosura nga APP, të cilave u ka kaluar afati ligjor 2 vjeçar, duke shtuar në kërkesat drejtuar Gjykatës edhe llogaritjen e kamat vonesave .

e) Bazuar në ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 4. Përgjegjësia për vjeljen e gjobave, të vendosura sipas pikës 1, të këtij neni, është e autoritetit kontraktor.

Për mos nxjerrjen e urdhrave dhe njoftimeve për ekzekutimin e vendimit të APP nr. nr.109, datë 16.11.2018 94, për 7 persona në vlerën në total prej 1.400.000 lekë dhe mos fillimin e procedurave ligjore për kryerjen e ndalesave z. K. N., kryetari i Bashkisë Këlcyrë, bëhet përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të parashkrimit të vendimeve prej 2 vjetësh (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, sipas vendimeve administrative të dënimit me gjobë.

8.BASHKIA KORÇË:

- Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Korçë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 484/7, datë 30.07.2018, protokolluar në Bashkinë Korçë me shkresën nr. 5042/2, datë 20.08.2018 ndërsa nga Bashkia Korçë për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 5042, datë 29.05.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 1299/16, datë 01.06.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Korçë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 484/7, datë 30.07.2018 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 30.01.2019 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA). Nga Bashkia Korçë është përgatitur dhe dërguar në KLSH me nr. 732, datë 29.01.2019 raporti me shkrim “Mbi zbatimin e rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH”.

B- MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr.

44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i Njësisë Publike, rikërkohen të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **25,783,615 lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej.....25,783,615 lekë

-Deri më datën 28.01.2019 për 3 rekomandime është arkëtuar533,317 lekë

Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej.....4,218,476 lekë

Nga të cilat:

-Në proces gjyqësor 5 rekomandime në vlerën..... 4,130,476 lekë

-Janë nisur njoftimet për 5 rekomandime por ende nuk kanë filluar arkëtimet.....88,000 lekë

1.1. Gjetje nga auditimi: Në testimet e kryera në hyrje/ daljet për muajt Janar, Maj dhe Gusht 2017, për likuidimet e mallrave të blerë nga të tretët dhe të dhuruara nga donatorët, u konstatua se nga Bashkia Elbasan janë bërë dalje (pa pagesë) në adresë të Bashkisë Korçë, tabela informuese për autobuzat e linjave dhe tabela informuese për stacionet e autobuzave. Nga Bashkia Korçë janë dokumentuar me fletë hyrjen nr. 35, datë 11.05.2017 “Tabela informuese për autobuzat e linjave” me vlerë 1,800,000 lekë.

Edhe pse Bashkia Korçë i ka marrë falas nga Bashkia e Elbasanit, konstatohet se kontrata datë 15.12.2006 nuk është zbatuar në afatin 12 mujor të përcaktuar për vendosjen e tabelave, afati ky i përfunduar 15.12.2017, në kundërshtim me pikën (b) e nenit 20 të kontratës, duke mos bërë të mundur llogaritjen e kamatëvonesës për mos mbylljen në afat të punimeve në vlerën **1,484,500 lekë, dëm ekonomik** (Trajtuar në pikën III/A (3.2), faqet 17-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan, të marrë masa administrative e ligjore ndaj kontraktuesit JV “H. S.” dhe “S. A.”, për mos zbatim të kushteve të kontratës datë 15.12.2006, për vendosjen e tabelave informuese në stacionet e autobuzëve urban dhe interurbane në Bashkinë Korçë.

Të ndiqen të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **1,484,500 lekë** nga JV “H. S.” dhe “S.A.”, si dhe të llogaritet kamatëvonesat shtesë deri në momentin e vendosjen e tabelave informuese.

Menjëherë

2.2. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e zbatimit të punimeve të ndërtimit me objekt “Rikonstruksion i veprave ujitëse në zonën jugperëndimore të Fushës së Korçës”, me vlerë 9,614,884 lekë me TVSH, sipas kontratës datë 21.03.2017 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe shoqërisë zbatuese “N.”, u konstatua se për zërat e punimeve: (Zëri (3.240) Beton për veshje C 12/15, në Leshnje, Pulahe dhe Bulgarec; zëri (An) Urë H.D 1 m, në Dvoran), janë likuiduar punime të pakryera me diferenca në volume në shumën **287,370 lekë pa TVSH**, duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar (Trajtuar në pikën III/C (1.4), faqet 156-168 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.2.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **287,370 lekë pa TVSH** nga shoqëria “N.”.

Menjëherë

3.4. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Ranovik” në ish- Komunën Drenovë, me fond limit 7,526,667 lekë dhe fitues operatorin “K.” për vlerën e kontratës prej 5,480,800 lekë, konstatohet se në zbatimin e kontratës datë 08.01.2014, afati për përfundimin e punimeve është 60 ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës (datë 06.08.2013). Nga dokumentacioni që shoqëron dosjen e subjekti të audituar, konstatohet se punimet kanë

përfunduar me datë 08.01.2014, pra jo sipas afatit të përcaktuar në dokumentet e tenderit i cili ka qenë 60 ditë kalendarike (nga data 07.08.2013 fillim punimesh deri datë 07.10.2013 sipas kushteve të DST). Pra punimet kanë përfunduar jashtë afatit të përcaktuar në DST me **90 ditë vonesë**, për të cilën nga mbikëqyrësi i punimeve ing. Th. F. me nr. licenc MK 373/1, datë 21.05.2013 dhe Nipt K640., nuk është bërë i mundur llogaritja e penalitetit në vlerën **1,564,568 lekë**, me dëm më buxhetin e ish-Komunës Drenovë (*Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3, faqet 106-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.4.1. Rekomandimi:Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **1,564,568 lekë** nga shoqëria “K.”.

Menjëherë

4.5. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës me objekt “*Blerje tubo*” në ish- **Komunën Drenovë**, me fond limit 2,189,653 lekë dhe fitues operatorin “I.” për vlerën 1,892,000 lekë, konstatohet se afati për dorëzimin e mallit është deri me datë 31.08.2014 nga data e lidhjes së kontratës datë 03.07.2015.

Subjekti ka paraqitur mallin për likuidim sipas faturës nr. 35, datë 31.08.2014 dhe fletë hyrjes në ish-komunë nr. 33, datë 31.08.2014 për shumën 830,400 lekë me TVSH.

Nga ana e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit, nuk është hartuar asnjë procesverbal mbi cilësinë dhe specifikimet teknike të marrjes së mallit si dhe nuk është llogaritur penaliteti për dorëzim me vonesë të mallit sipas kushteve të DST dhe kontratës.

Konstatohet se jo i gjithë sasia është dorëzuar në afatin e caktuar datë 31.08.2014, pasi një sasi me vlerë 1,440,000 lekë (tubo d=314 korogato prej 1600 ml është dorëzuar në dhjetor 2014, sipas faturës tatimore nr. 8, datë 13.12.2014 dhe FH nr. 52, dt. 13.12.2014) ose me **106 ditë** vonesë nga momenti që duhet të paraqitet malli, dhe nuk është bërë i mundur llogaritja e penalitetit në masën 4/1000/ditë, në zbatim të nenit 45 të kushteve të kontratës paraqitur në DST, për vlerën **610,560 lekë**, veprim financiar me pasoja negative me dëm më buxhetin e ish- Komunës Drenovë (*Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3, faqet 106-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.5.1. Rekomandimi:Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **610,560 lekë** nga shoqëria “I.”.

Menjëherë

5.7. Gjetje nga auditimi: Në ish- **Komunën Vithkuq** në auditimin e procedurës së prokurimit me objekt “*Sistemim i rrugëve në fshatin Lubonjë, Rehovë, Leshnjë*” me fond limit 2,239,471 lekë, ku fitues është shpallur BOE “A. + R.G.” me vlerë kontrate 2,097,290 lekë, konstatohet se:

Bashkimi i Operatorit Ekonomik i shpallur fitues “A. + R. G.”, nuk plotëson kriteret e miratuara në DST, si:-*Kontrata e bashkëpunimit nuk është në zbatim të LPP, pasi përqindja midis dy shoqërive e cila është 90% shoqëria “A.” dhe 10% shoqëria “R.K.”, nuk janë ndarë zërat e preventivit se cilat punime do ketë një shoqëri e cila tjetra; -Shoqëria “R. G.”, nuk plotëson kriterin e veçantë në lidhje me licencën profesionale (pika 2.1/b e DST), pasi nuk disponon kategoritë e punimeve NP-5, NP-9 dhe NS-18; -Nuk plotëson piken 2.3/d e DST.*

Nga të dy shoqëritë nuk janë paraqitur dokumente që tregojnë se në licencat e shoqërive ka ing. Ndërtimi dhe Ing. Topograf (licencat përkatëse).

Në lidhje me shoqërinë “Vashtemia” e skualifikuar nga KVO, mangësitë e evidentuara nuk qëndrojnë, pasi nga verifikimi në sistem të dy dokumentet janë paraqitur nga shoqëria.

Si rezultat KVO ka shpallur si fitues BOE “A. + R.G.” me ofertë më të lartë se operatori “V.” për vlerën **88,000 lekë**, veprime me efekt negativ me dëm në buxhetin e ish- Komunës Vithkuq (*Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3, faqet 117-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.7.1. Rekomandimi:Bashkia Korçë të marrë masa të analizojë me grup pune të veçantë duke nxjerrë shkaqet dhe arsyet për dëmin ekonomik të shkaktuar prej **88,000 lekë**, ndaj punonjësve dhe drejtuesit përgjegjës në procedurën me objekt “*Sistemim i rrugëve në fshatin Lubonjë, Rehovë, Leshnjë*”, të zhvilluar në ish- Komunën Vithkuq.

Menjëherë

6.9. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës me objekt “Blerje Automjeti” në ish- Komunën Lekas, me fond limit 750,000 lekë dhe fitues OE “R.” për vlerën 749,500 lekë, konstatohet se nuk janë respektuar afatet e dorëzimit të mallit përcaktuar në kontratën nr. --, datë 23.07.2013 (27 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Sipas dokumentacionit në dosje, shoqëria ka dorëzuar mallin me faturën e TVSH nr. 29 (seri 06056622), datë 11.10.2013 për vlerën 899,400 lekë, ose më shumë seç parashikon kontrata dhe kërkesat e DST për **51 ditë vonesë** (nga data 20.08.2013 deri me datë 11.10.2013). Detyrimi për kamatën e pallogaritur paraqitet në vlerën **183,478 lekë** (Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3, faqet 133-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.9.1. Rekomandimi:Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për ti kërkuar shoqërisë “R.”, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e **vlerës 183,478 lekë**.

Menjëherë

9.BASHKIAKOLONJË:

- Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Kolonjë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 487/8, datë 31.07.2018, protokolluar në Bashkinë Kolonjë me shkresën nr. 1670, datë 02.08.2018 ndërsa nga Bashkia Kolonjë për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 1775, datë 17.08.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Kolonjë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 487/8, datë 31.07.2018 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 31.01.2019 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA)

Nga Bashkia Kolonjë është përgatitur dhe dërguar në KLSH me nr. 255, datë 30.01.2019 raporti me shkrim “Mbi zbatimin e rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH”.

A.MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Kolonjë 14 masa organizative, të cilat janë pranuar dhe prej tyre, janë zbatuar plotësisht 8 masa, janë në proces zbatimi 6 masa dhe nuk ka masa organizative të pa zbatuara. KLSH rikërkon zbatimin e plotë të 6 rekomandimeve të cilat janë në proces zbatimi si më poshtë:

1.2. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Kolonjë u konstatua se ka një vëllim të konsiderueshëm faturash të palikuiduara, në shumën totale prej 133,305,568 lekë, për shërbime dhe mallra të prokuruar, një pjesë e të cilave janë të trashëguara nga ish-komunat dhe një pjesë të krijuara pas reformës territoriale, si dhe 15,821,942 lekë nga vendime gjyqësore të formës së prerë. (Trajtuar më hollësisht në faqet 36-78 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

1.2.1. Rekomandim: Në mënyrë që të mos krijohen fenomene të tilla dhe faturat të paguhen duke respektuar afatet ligjore, nga Bashkia Kolonjë të merren masa për monitorimin dhe shlyerjen e detyrimeve të bashkisë që diktohen nga vendime gjyqësore të formës së prerë, në mënyrë që të mos rëndohet buxheti i bashkisë me interesa apo penalitete të tjera për shkak të moslikuidimit të detyrimeve.

Në vazhdimësi

2.6. Gjetje nga auditimi:Nga auditimi i kryer, u konstatua se dokumentacioni për subjektet që ushtrojnë aktivitet privat në territorin e Bashkisë Kolonjë, aktualisht ndodhet në çdo njësi administrative. Kjo bie ndesh me përcaktimet në VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të

prekura nga riorganizimi administrativo-territorial” dhe të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit për Çështjet Vendore dhe ministrit të Financave nr. 3237, datë 16.7.2015 “Për procedurat, afatet kohore, standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorial”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 15-36 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

2.6.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, të marrë masa për grumbullimin e të gjithë dokumentacionit në arkivin qendror të njësisë vendore, në përputhje me VKM dhe Udhëzimin e mësipërm. Në njësitë administrative mund të qëndrojnë kopje të këtij dokumentacioni, por gjithsesi, njësitë e dokumentacionit origjinal duhet të depozitohen menjëherë pranë arkivit të bashkisë.

Menjëherë

3.7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se midis Bashkisë Kolonjë dhe ish-komunave me kompaninë A. janë lidhur 6 kontrata duke filluar që nga viti 2004 me një vlerë vjetore prej 1,900,000 lekë. Kjo kompani ka shlyer të gjitha detyrimet për këto kontrata, përveç kontratës së Radanjit e lidhur në datën 23.03.2004 deri më 22.03.2034 me ish komunën Qendër Leskovik, me vlerë 250.000 lekë. Kjo kontratë i nënshtrohet rivlerësimit sipas VKM-së 1064, të datës 22.12.2010 dhe kalon me shumën 400.000 lekë në vit, shumë të cilën kompania nuk e ka pranuar. Detyrimi i pa paguar nga kjo kompani për periudhën e audituar është 1.583.700 lekë. Ky detyrim nuk është kontabilizuar për vitin 2017.

Me kompaninë P. janë lidhur 3 kontrata duke filluar që nga viti 2010 me një vlerë vjetore prej 1.150.000 lekë. Kjo kompani nuk ka shlyer detyrimet që nga data 24.09.2015 për kontratën G6401 Pepellash, 01.10.2015 për kontratën G6403 Ersekë, dhe 24.03.2016 për kontratën G6402 Leskovik. Ka njoftime për detyrimet e lindura për këtë kompani. Shuma e detyrimit për këtë kompani është në shumën 2.316.163 lekë, detyrim i pa kontabilizuar për vitin 2017. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 155-157 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

3.7.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, të kontabilizojë shumën e detyrimit prej 1,583,700 lekë në ngarkim të subjektit A. dhe shumën 2,316,163 lekë në ngarkim të subjektit P. dhe të kërkojë sipas ligjit, arkëtimin e këtyre vlerave nga personat përkatës juridikë, duke vazhduar me procedurat përkatëse administrative, ligjore dhe gjyqësore, përfshirë edhe prishjen e kontratave dhe heqjen e antenave nga territori i saj.

Menjëherë

4.10. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Kolonjë nuk janë ndërmarrë hapat ligjore për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë në ZVRPP Kolonjë, në zbatim të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 161-162 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

4.10.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e pronave dhe për krijimin e regjistrimit të pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Kolonjë, në zbatim të VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

Menjëherë

5.12. Gjetje nga auditimi: Në Njësinë shpenzuese, Bashkia Kolonjë për periudhën raportuese 2016 u konstatua se, ndërmjet gjendjes fizike të vlerave të aktiveve dhe gjendjes kontabile e pasqyruar në pasqyrën financiare rezultojnë diferenca në gjendjen fizike dhe kontabile, ndërsa për periudhën raportuese 2017 si pasojë e mos përfundimit brenda afatit të procesit të inventarizimit fizik të aktiveve dhe vlerave materiale, mos nxjerrja e rezultatit dhe sistemimi diferencave brenda periudhës së ndërtimit të pasqyrave financiare nuk mund të quhet se ato pasqyrojnë realitetin e gjendjes së pasurisë të institucionit *(Trajtuar më hollësisht në faqet 36-78 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

5.12.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, Zyra e Financës dhe Kontabiliteti të marr masat të plota për të sistemuar diferencat e rezultuara ndërmjet gjendjes fizike dhe kontabile të periudhës raportuese 2016, si dhe përfundimin e menjëhershëm të procesit të inventarizimit fizik të aktiveve të pasurisë e aseteve të institucionit me qëllim saktësimin e gjendjes fizike e kontabile për periudhën raportuese 2017.

6.14. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kolonjë nuk ka funksionuar në bazë strategjish periodike dhe objektiva prioritar. Nga auditimi dhe komunikimi me subjektin rezulton se për periudhën objekt i auditimit në Bashkinë Kolonjë nuk janë parashikuar plane vjetore dhe operacionale aktiviteteve për realizimin e objektivave por ndjekja e realizimit të detyrave dhe përgjegjësisë të përshkuara në Rregulloren e brendshme si dhe monitorimi e raportimi funksionojnë në mënyrë operative si dhe nuk ka aplikuar metodën e vlerësimit dhe menaxhimit të risqeve që kërcënojnë realizimin e objektivave dhe respektivisht realizimin e funksioneve kryesore të ngarkuara sipas kuadrit rregullator në fuqi. Nga auditimi i evidencës së grumbulluar, raportimet e nivelit drejtues dhe përgjigjet e stafit të administratës në pyetësorët e aplikuar për këtë qëllim rezulton se nuk janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe veçanërisht në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm (*Trajtuar më hollësisht në faqet 15-36 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

6.14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë, në ushtrim të përgjegjshmërisë menaxheriale të institucionit që drejton, të formojë një grup pune me specialistë me njohuri të spikatura profesionale me qëllim që:

a) Të organizojë punën për vlerësimin e situatës aktuale të veprimtarisë së bashkisë, identifikimin e dobësive, kërcënimeve dhe oportuniteteve dhe ndërtimin e strategjisë afatmesme e afatshkurtër të bashkisë duke marrë në konsideratë prioritetet e bashkisë në vijimësi.

b) Pas përfshirjes në strategji të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve profesionale si objektiv prioritar, të vlerësojë nevojat për trajnime të stafit kryesisht në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe të hartojë plane vjetore dhe operacionale aktiviteteve për realizimin e objektivave në tërësi dhe ato në fushën e trajnimeve në veçanti.

6.14.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë nëpërmjet koordinatorit të riskut të ndërtojë një plan pune me detyra të mirë përcaktuara për të organizuar punën në bashki për aplikimin e funksionimit të institucionit me bazë vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në çdo nivel të administratës dhe dokumentimin në regjistrin qendror të riskut në vazhdimësi si rezultat i rishikimit dhe rivlerësimit të risqeve me qëllim garantimin e arsyeshëm dhe në nivel sa më optimal të realizimit të objektivave dhe misionit të bashkisë.

Rekomandimet sa më sipër, në referencë të përcaktimeve në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, neni 8, pika 8; neni 10; neni 16; neni 21; dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010.

D. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 57, pika 2; 58 “Ilojet e masave disiplinore” shkronja “ç”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64, shkronjat “g” dhe “k”, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, KLSH **rekomandon Kryetarit të Bashkisë** që t’i rikërkojë Komisionit Disiplinor, pranë Bashkisë Kolonjë, **të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil” për z.R. B., punonjësit e auditit të brendshëm.**

E. MASA ADMINISTRATIVE;

E/I. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në akt-konstatimet, vërejtjeve dhe komenteve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit përfundimtar të auditimit, mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014

miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH i ka **rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) ose masa disiplinore në raport me të metat e mangësitë e konstatuara në punën e tyre si anëtar të KVO, 11 punonjësve të Bashkisë Kolonjë.

Nga verifikimi rezulton se APP, në zbatim të kërkesës sa më sipër, është shprehur me vendim nr. 112, dhe nr. 7539/12 prot datë 23.11.2018, duke dënuar me gjoba 15 punonjës si më poshtë:

- 1.G. D., 100,000 lekë.
- 2.G. E., 90,000 lekë.
3. A. C., 80,000 lekë.
4. P. K., 70,000 lekë.
5. R. B., 60,000 lekë.
6. Th. A., 60,000 lekë.
7. Sh. L., 50,000 lekë.
8. E. H., 50,000 lekë.
9. K. Q., 50,000 lekë
10. Gj. K., 50,000 lekë.
11. G. K.,30,000 lekë
- 12.L. K.,30,000 lekë
13. F. K., 30,000 lekë.
14. R. K., 20,000 lekë
- 15.E. Z., 20,000 lekë.

Për gjobat e vendosura nga APP, me vendimin nr.112, datë 23.11.2018nga Bashkia Kolonjë,Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës të kontabilizohen vlera e vendimeve të gjobave të vendosura nga APP. Në rast mosarkëtimi nga ana e bashkisë të shumës së mësipërme, KLSH kërkon që të meren masat e mëposhtme:

a) Të marrë masa për dërgimin në Gjykatë dhe kthimin në tituj ekzekutiv, të vendimeve të gjobave të vendosura nga APP, sikurse parashikohet në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, konkretisht në nenin 24-*Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv.*

b) Të marë masa për llogaritjen e kamat vonesave për gjobat e vendosura nga APP, bazuar në ligjin nr.10279,datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”,**neni 30-”Arkëtimi i shumave të detyrimeve”ku parashikohet se: 3.Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë paguhet kamat 2 për qind në muaj të masës gjobës**, me përjashtim të rasteve kur ligji i posaçëm parashikon përqindje të ndryshme për kamatëvonesat.

c. Kryetari i bashkisë, **të fillojë procedurat largimit nga puna**,ndaj personit përgjegjës i cili nuk ka nisur procedurat e nevojshme ligjore të vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të gjobës), bazuar në ligjin nr.10279,datë 20.05.2010”Për kundërvajtjet administrative”, pika 5) ku parashikohet se **-neni 44” Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”**, në rast se gjobat dhe detyrimet e tjera, të vendosura nga vendimi për kundërvajtjen administrative, nuk paguhen për mosveprim të punonjësit të organit administrativ, i cili ka miratuar vendimin përkatës dhe detyrimin që të kërkojë arkëtimin e shumave, apo për shkak se punonjësi nuk nis procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ, **atëherë ndaj tij fillojnë procedurat e largimit nga puna.**

d. Drejtoria Juridike, bazuar në nenet 151 dhe 152, të “Kodit Procedurës Civile në RSH”, të marrin masa dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për vendimet e dënimit me gjobë të vendosura nga APP, të cilave u ka kaluar afati ligjor 2 vjeçar, duke shtuar në kërkesat drejtuar Gjykatës edhe llogaritjen e kamat vonesave .

e) Bazuar në ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar,pika 4. Përgjegjësia për vjeljen e gjobave, të vendosura sipas pikës 1, të këtij neni, është e autoritetit kontraktor.

10.BASHKIA PUSTEC:

- Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Pustec rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.486/6, datë 31.07.2018, protokolluar në Bashkinë Pustec me shkresën nr.299/2, datë 03.08.2018, ndërsa nga Bashkia Pustec për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.299/2, datë 03.08.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Pustec, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.486/6, datë 31.07.2018 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 31.01.2019 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA),por nuk ka raportuar.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Pustec 11 masa organizative, të cilat janë pranuar dhe prej tyre, janë zbatuar plotësisht 5 masa, janë në proces zbatimi 4 masa dhe 2 masa organizative nuk janë zbatuar, respektivisht: rekomandimet 2.1 dhe 11.1 për të cilat rikërkojmë zbatimin e masave si vijon:

1.2. Gjetje nga auditimi: Si rezultat i punës së pa mjaftueshme të zyrës së taksave dhe tarifave vendore, në fund të vitit 2017, rezultojnë debitorë për taksa dhe tarifa vendore në **vlerën totale 3,622,619 lekë**, e cila përbëhet nga detyrimet e 17 subjekteve private në shumën 251,070 lekë dhe vlera 3,371,549 lekë detyrime për taksat dhe tarifave vendore nga taksapaguesit familjar.

Spektori i taksave dhe tarifave vendore nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e debitorëve, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, nenet 90 dhe 91, të ligjit nr. 9920, ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe pika 12 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve” (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 26-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.2.1. Rekomandim: Nga Spektori i Financës dhe Spektori i Taksave në Bashkinë Pustec, të merren masa për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore, për 17 subjekte debitorë në shumën 251,070 lekë, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, duke **ndjekur rrugët e mëposhtme:**

a. Tu dërgohen bankave urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

b. Të dërgojë në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

c. Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 % kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në R. Sh.”, të ndryshuar.

1.2.2. Rekomandim: Spektori i taksave dhe tarifave vendore të marrë masa për hartimin e listës elektronike për abonentët familjare, sipas të dhënave të Gjendjes Civile, si dhe të kërkojë arkëtimin e **vlerës 3,371,549 lekë**, duke dërguar njoftim vlerësimet abonentëve familjarë me nëpërmjet postës, për:

- taksë toke për 867 familje me vlerë 1,303,918 lekë;
- taksë ndërtese për 643 familje me vlerë 401,390 lekë;
- taksë trualli për 643 familje me vlerë 2,250 lekë;
- tarifë pastrimi për 554 familje me vlerë 1,385,500 lekë;
- tarifë ndriçimi për 554 familje me vlerë 278,491 lekë;

Menjëherë

2.11. Gjetje nga auditimi: Ish Komuna Pustec është audituar nga KLSH sipas programit të auditimit nr.25/1 prot., datë 06.03.2015 dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes janë dërguar

me shkresën nr. 256/6 prot., datë 18.06.2015. Për arsye të reformës administrativo-territoriale të drejtat dhe detyrimet e ish komunës kanë kaluar në Bashkinë Pustec dhe në këtë mënyrë ka detyrimin ligjor për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH për ish komunën. Zbatimi i rekomandimeve është audituar nga KLSH sipas programit të auditimit nr. 1015, datë 03.11.2015 dhe në Raportin përfundimtar të këtij auditimi është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve të pa zbatuara. Nga auditimi u konstatua se nga 10 masa për shpërbllim dëmi në vlerën totale 1,241,072 lekë, është zbatuar pjesërisht 1 masë, me vlerën e realizuar të arkëtimit 62,500 lekë. Për 9 masa të tjera janë nxjerrë urdhrat e titullarit, por nuk është arkëtuar detyrimi dhe nuk janë marrë masa të tjera, duke mos ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin i detyrimit në vlerën totale 1,178,527 lekë, ende i pa arkëtuar. Nuk është bërë kontabilizimi në pasqyrat financiare i detyrimit për shpërbllimin e dëmit ekonomik të lënë në rekomandimet e KLSH-së (*Më hollësisht trajtuar në pikën H, faqe 62-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.11.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Pustec, Zyra juridike dhe Nëpunësi zbatues, të hartojnë plan pune të veçantë e të marrin të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, në vlerën totale **1,178,527 lekë**. Nga nëpunësi zbatues, bazuar mbi urdhrat e nxjerrë nga titullari të bëhet kontabilizimi i detyrimeve të pa arkëtuar.

Menjëherë

11.BASHKIA POLIÇAN:

-Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Poliçan rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.488/12,datë 02.08.2018,ndërsa nga Bashkia Poliçan për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën nr.1241/56, datë 15.10.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nuk është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Poliçan, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.488/12, datë 02.08.2018 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 02.02.2019 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brënda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA),por nuk ka raportuar në afat.

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.9- Gjetje nga auditimi: Bashkia Poliçan nuk ka marrë masa dhe nuk ka ndjekur procedurën ligjore për arkëtimin e vlerës **181,000 lekë** nga operatori ekonomik “I.”shpk, sa paguar për situacionimin e volumeve të punimeve të pa kryera në objektin “*Rikonstruksion i Zyrave të Administratës së Bashkisë Poliçan*”, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH sipas shkresës nr.1194/7, datë 13.05.2016 “*Raporti përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet*”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 12-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.9.3- Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Poliçan të merren masat për të sistemuar në kontabilitet vlerën **136,535 lekë** të ngurtësuar si mjete në ruajtje si garanci e punimeve të kryera për llogari të operatorit ekonomik “I.” shpk Tiranë dhe për të arkëtuar vlerën prej **44,465 lekë**,rekomandim i pa realizuar nga auditimi i mëparshëm, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit.

Menjëherë

2.9-Gjetje nga auditimi: Bashkia Poliçan të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **172,050 lekë** nga operatori ekonomik “B.”shpk, ka paguar në kundërshtim me kushtet e kontratës nr.739/19, datë 08.10.2014, për situacionimin e volumeve të punimeve të pa kryera në objektin “*Rikonstruksion i Kopështit të Fëmijëve nr.2 Poliçan*”, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH sipas shkresës nr.1194/7, datë 13.05.2016 “*Raporti përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet*”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 12-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.9.4- Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Poliçan të merren masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **172,050 lekë** përfituar nga operatori ekonomik “B.” për situacionimin e punimeve të pa kryera, rekomandim i pa realizuar nga auditimi i mëparshëm, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit.

Menjëherë

3.9- Gjetje nga auditimi: Vlera e tatimit në burim të pa ndalur për vitin 2014 prej vlerës **300,000 lekë** nga operatori, të dëmshpërblehet nga urdhëruesit e pagesave z. A. Z., me detyrë Kryetar i Bashkisë Poliçan, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj.V. A., me detyrë Drejtor i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, e cila nuk ka kryer ndalesat në listë pagesat e likuidimit të tyre, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH sipas shkresës nr.1194/7, datë 13.05.2016 “Raporti përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 12-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.9.5- Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Poliçan të merren masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **300,000 lekë** gjithsej nga z. A. Z., me detyrë Kryetar i Bashkisë Poliçan, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj.V. A., me detyrë Drejtor i Financës, nga **150,000 lekë secili**, rekomandim i pa realizuar nga auditimi i mëparshëm, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit.

Menjëherë

4.9-Gjetje nga auditimi: Nga Policia Bashkiake Poliçan, bazuar në nenin 14 pika 2 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe nenet 9, 22, dhe 30 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” të merren masa dhe të ndiqet në rrugë administrative arkëtimi i vlerave të gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake dhe të penaliteteve në vlerën **23,420 lekë** gjithsej, respektivisht: për 4 kundërvajtës në vlerën 4,000 lekë dhe kamat vonesa nga kundërvajtësit në vlerën 19,420 lekë, në të kundërtën vlera prej **23,420 lekë** të paguhen nga punonjësit e policisë, të cilët nuk kanë marrë masa për ekzekutimin e këtyre gjobave, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH sipas shkresës nr.1194/7, datë 13.05.2016 “Raporti përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 12-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.9.6- Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Poliçan të merren masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **23,420 lekë** gjithsej nga z. S. L., në vlerën **15,720 lekë** dhe P. Z. në vlerën **7,700 lekë**, rekomandim i pa realizuar nga auditimi i mëparshëm, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit.

Menjëherë

5.9-Gjetje nga auditimi: Bashkia Poliçan dhe IMTV nuk kanë marrë masa për arkëtimin e vlerës **1,300,000 lekë** për gjobat e vendosura nga IMTV duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore të përcaktuara në ligjin nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i procedurës civile” i ndryshuar dhe ligjin nr. 9780, datë16.07.2007 i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 01.04.2013 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH sipas shkresës nr.1194/7, datë 13.05.2016 “Raporti përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet”.(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 12-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.9.7- Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Poliçan të merren masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit për gjobat e vendosura nga IMTV në vlerën **1,300,000 lekë** gjithsej, rekomandim i pa realizuar nga auditimi i mëparshëm, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit.

Menjëherë

B/1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **KLSH i ka rekomanduar Titullarit të Njësisë Publike, Kryetarit të Bashkisë Poliçan**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha

shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **16,823,928 lekë**, si më poshtë:

-Nga vlera e rekomanduar gjithsej vlera prej.....16,823,928 lekë

- Nga e cila nuk është pranuar dhe kontabilizuar vlera prej.....12,826,986 lekë

-Deri më datën 31.12.2018 është arkëtuar.....129,160 lekë

Deri më datën 31.12.2018 kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej3,867,782lekë

Nga të cilat:

-Në proces arkëtimi 6 rekomandime në vlerën 686,658 lekë

-Janë nisur njoftimet për 4 rekomandime por ende nuk kanë filluar arkëtimet... 3,178,123 lekë

1- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në procedurën e prokurimit me objekt: “Kanali ujitës i fshatit Mbrakull (rehabilitim i kanalit ujitës të fshatit Mbrakull)”, me fond limit 21,938,960 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 16.02.2017, është konstatuar dëm ekonomik **në vlerën prej 179,111 lekë**, si rezultat i përllogaritjes gabim të vlerës së fondit limit, ku person përgjegjës është projektuesi i objektit Znj. L. V. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 122-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1-Rekomandim: Të kontabilizohet dhe kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **179,111 lekë**, përkatësisht nga projektuesi i objektit.

Menjëherë

2- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikualifikimi i fasadave në shëtitoren Miqësia dhe rehabilitimi i rrugës së tregut”, me fond limit 6,926,312 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.04.2017, është konstatuar dëm ekonomik **në vlerën prej 480,147 lekë**, si rezultat i përllogaritjes gabim të vlerës së fondit limit, ku person përgjegjës është projektuesi i objektit Z. L. N.. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 129-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1-Rekomandim: Të kontabilizohet dhe kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **480,147 lekë**, përkatësisht nga projektuesi i objektit, lidhur me dëmin ekonomik të shkaktuar në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikualifikimi i fasadave në shëtitoren Miqësia dhe rehabilitimi i rrugës së tregut”.

Menjëherë

3- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në procedurën e prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i zonës së pallateve të ish mapos dhe rikualifikimi i fasadave të pallateve”, me fond limit 19,337,946 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.04.2017, është konstatuar dëm ekonomik **në vlerën prej 1,636,012 lekë**, si rezultat i përllogaritjes gabim të vlerës së fondit limit, ku person përgjegjës është projektuesi i objektit Z. L. N.. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 132-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1-Rekomandim: Të kontabilizohet dhe kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **1,636,012 lekë**, përkatësisht nga projektuesi i objektit, lidhur me dëmin ekonomik të shkaktuar në procedurën e prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i zonës së pallateve të ish mapos dhe rikualifikimi i fasadave të pallateve”.

Menjëherë

4- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje automjetesh për nevojat e Bashkisë Poliçan, 2017”, me fond limit 5,833,330 lekë pa TVSH, sipas U.P. datë 21.02.2017, është konstatuar dëm ekonomik **në vlerën prej 14,400 lekë**, si rezultat i përllogaritjes gabim të vlerës së fondit limit, ku personat përgjegjës janë të gjithë anëtarët e komisionit të përllogaritjes së vlerës së fondit limit konkretisht Z. N. Q., Znj. K. M., Znj. A. H. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 144-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1-Rekomandim: Të kontabilizohet dhe kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **14,400 lekë**,

përkatësisht nga personat përgjegjës konkretisht Z. N. Q., Znj. K. M., Znj. A. H., lidhur me dëmin ekonomik të shkaktuar në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje automjetesh për nevojat e Bashkisë Poliçan, 2017”.

Menjëherë

5- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale për objekte ndërtimore”, me fond limit 4,166,667 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 06.03.2017, është konstatuar dëm ekonomik në vlerën prej **509,388 lekë**, si rezultat i mos mbajtjes së penalteteve për dorëzimin e mallit me vonesë, në kundërshtim me kontratën Nr. 276/12 Prot., datë 15.03.2017, ku përgjegjës është kontraktori “F.” Sh.p.k. i cili ka dorëzuar mallin me vonesë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 147-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1-Rekomandim: Të kontabilizohet dhe kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **509,388 lekë**, përkatësisht nga kontraktori, lidhur me dëmin ekonomik të shkaktuar në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale për objekte ndërtimore”.

Menjëherë

6- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale për objekte ndërtimore”, me fond limit 4,166,667 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 06.03.2017, është konstatuar dëm ekonomik në vlerën prej 802,187 lekë, si rezultat i përlllogaritjes gabim të vlerës së fondit limit, ku personat përgjegjës janë të gjithë anëtarët e komisionit të përlllogaritjes së vlerës së fondit limit, konkretisht Z. N. Q., Znj. K. M., Znj. A. H.. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 147-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1-Rekomandim: Të kontabilizohet dhe kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **802,187 lekë** ngapersonat përgjegjës konkretisht, Z. N. Q., Znj. K. M., Znj. A. H., lidhur me dëmin ekonomik të shkaktuar në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale për objekte ndërtimore”.

Menjëherë

7- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje materiale ndërtimore për sistemimin e rrugës së varrezave të vjetra, sistemimin e rrugës së Unazës Plirëz-Kullusem-Poliçan”, me fond limit 10,950,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 06.06.2016, është konstatuar dëm ekonomik në vlerën prej **84,000 lekë**, si rezultat i mosdokumentimit dhe argumentimit të daljes së mallit, ku person përgjegjës është Z. R. B. në cilësinë e Drejtorit të Shërbimeve Publike dhe Mirëmbajtjes së Rrugëve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 155-163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1-Rekomandim: Të kontabilizohet dhe kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **84,000 lekë**, përkatësisht nga Z. R. B., lidhur me dëmin ekonomik të shkaktuar në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale ndërtimore për sistemimin e rrugës së varrezave të vjetra, sistemimin e rrugës së Unazës Plirëz-Kullusem-Poliçan”.

Menjëherë

8- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion dhe asfaltimi i rrugës Prokuce-Bodure-Kapinovë, loti I”, me fond limit 99,999,992 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 12.05.2017, është konstatuar dëm ekonomik në vlerën prej **9,908,640 lekë**, si rezultat i përlllogaritjes gabim të vlerës së fondit limit, ku person përgjegjës është projektuesi i objektit Z. E. S.. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 163-171 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1-Rekomandim: Të kontabilizohet dhe kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **9,908,640 lekë**, përkatësisht ngaprojektuesi i objektit Z. E. S., lidhur me dëmin ekonomik të shkaktuar në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion dhe asfaltimi i rrugës Prokuce-Bodure-Kapinovë, loti I”.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr.180 datë 08.04.2016 në vlerën 2,760,000 lekë (zbritur 5% garanci defektesh në vlerën 138,000 lekë duke mbetur për likuidim vlera 2,622,000 lekë) për llogari të operatorit ekonomik "B." Fier me objekt blerje autovetura.

Nga verifikimi i dokumentacionit të pagesës rezulton se fatura nr.37 datë 06.04.2016 në vlerën 9,996,000 lekë e operatorit ekonomik "B." Fier është dokumentuar me fletë hyrjen e magazinës nr.27 datë 15.03.2016 dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim të automjeteve dhe makinerive datë 15.03.2016 ose **22 ditë para faturës së shitësit** të cilat nuk përmbushin kushtet e dokumentit të rregullt për efekt pagese dhe konsiderohen jo të sakta.

- Sipas faturës tatimore nr.37 datë 06.04.2016 rezulton se për operatorin ekonomik "B.", duke llogaritur afatin e kontraktuar, nuk është aplikuar sanksion për 17 ditë vonesa në dorëzimin e automjeteve dhe makinerive sipas përcaktimeve të bëra në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës neni 24.1 Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar pika a e DST vlera e fondit limit 19,992,000 lekë x 17 ditë vonesa x 4/000 lekë për ditë vonesë baras në vlerën **1,359,456 lekë**, e cila përbën të ardhur të munguar, shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Poliçan dhe detyrim për arkëtim nga operatorin ekonomik "B."

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, kreu II, pika 2 germa ç, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Sektorin Publik" dhe UMF nr. 33, datë 11.07.2013 "Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë". (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 32-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1- Rekomandimi: Bashkia Poliçan të marrë masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **1,359,456 lekë** përfituar nga operatori ekonomik "B." nga mos aplikimi i kamatvonesave për 17 ditë në dorëzimin e makinerive sipas kontratës nr. 260/15, datë 15.03.2016, për blerje makineri duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr.189 datë 14.04.2016 në vlerën 646,560 lekë për llogari të operatorit ekonomik "N. H." Tiranë me objekt "Blerje pjesë këmbimi për automjete".

Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël me miratimin nga ana e titullarit ka nxjerrë urdhër prokurim nr.15 datë 10.03.2016 me fondin limit në vlerën 600,000 lekë pa TVSH, ftesën për ofertë datë 10.03.2016, procesverbalin e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nr.2 datë 11.03.2016 dhe nr. 5 datë 16.03.2016, formularine njoftimit të fituesit datë 17.03.2016, fatura nr. 162 datë 29.03.2016, fletë hyrja nr.28 datë 29.03.2016 dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim të pjesëve të këmbimit datë 30.03.2016.

- Formularët e deklarimit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël mbajnë datën 15.03.2016 ose 5 ditë pas zhvillimit të prokurimit.

- Për operatorin ekonomik "N. H." nuk është aplikuar sanksion për 5 ditë vonesa në dorëzimin e pjesëve të këmbimit sipas përcaktimeve të bëra në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës neni 24.1 Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar pika a e DST vlera e fondit limit 646,560 lekë x 5 ditë vonesa x 4/000 lekë për ditë vonesë baras në vlerën **12,931 lekë**, e cila përbën të ardhur të munguar, shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Poliçan dhe detyrim për arkëtim nga operatori ekonomik "N. H."

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, kreu II, pika 2 germa ç, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Udhëzimin APP nr. 5, datë 27.01.2015 "Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla", UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Sektorin Publik" dhe UMF nr. 33, datë 11.07.2013 "Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë". (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 32-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1- Rekomandimi: Bashkia Poliçan të marrë masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **12,931 lekë** përfituar nga operatori ekonomik "N. H." për dorëzimin me vonesë të mallrave duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr. 209, datë 21.04.2016 në vlerën 10,200 lekë, nr. 210, datë 21.04.2016 në vlerën 3,000 lekë, nr. 211, datë 21.04.2016 në vlerën 12,500 lekë, nr. 212, datë 21.04.2016 në vlerën 4,700 lekë, nr. 213, datë 21.04.2016 në vlerën 9,500 lekë, nr. 214, datë 21.04.2016 në vlerën 7,500 lekë, nr. 215, datë 21.04.2016 në vlerën 5,100 lekë, nr. 216, datë 21.04.2016 në vlerën 4,200 lekë, nr. 217, datë 21.04.2016 në vlerën 3,900 lekë, nr. 218, datë 21.04.2016 në vlerën 3,200 lekë për llogari të operatorit ekonomik "A. L." është kryer pagesë për shërbimin e larjes dhe mirëmbajtjes të mjeteve të transportit sipas urdhër prokurimit me vlera të vogla nr.111 datë 30.12.2011 me fondin limit në vlerën 150,000 lekë pa TVSH, kontratës nr.68/1, datë 05.01.2012 në vlerën 114,000 lekë pa TVSH.

Faturat e thjeshta tatimore nr.1 datë 01.02.2012, nr.4 datë 01.03.2012, nr.7 datë 01.04.2012, nr.9 datë 31.05.2012, nr.11 datë 22.06.2012, nr.12 datë 29.06.2012, nr.14 datë 31.07.2012, nr.16 datë 31.08.2012, nr.18 datë 28.09.2012 dhe nr.20 datë 31.10.2012 në vlerën **63,800 lekë** gjithsej të paraqitura nga operatori ekonomik "A. L." nuk përmbushin kushtet e dokumentit të rregullt për efekt pagese dhe konsiderohen fiktive/jo të sakta pasi:

së pari: Dokumentet për shërbimet e mirëmbajtjes janë pa specifikime (*procese pune*) konkrete dhe pa data të shërbimeve të kryera, pa targa të automjetit të cilit i është kryer shërbimi,

së dyti: Në vlerën e mësipërme të shërbimeve të mësipërme prej **63,800 lekë** është përfshirë edhe vlera prej **11,700 lekë** për blerje goma 2 copë në vlerën 6,000 lekë dhe blerje pjesë këmbimi si cilindër frenash 1 copë në vlerën 3,500 lekë, pasqyrë ferrotash i copë në vlerën 2,000 lekë dhe llampa sinjali copë 2 në vlerën 200 lekë të cilat nuk janë dokumentuar në magazinë.

Për rrjedhojë pagesat e mësipërme konsiderohen si pagesë e pa argumentuar dhe përbëjnë shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik ndaj Bashkisë Poliçan në vlerën **63,800 lekë** dhe detyrim për arkëtim nga V. A. me detyrë ish drejtor finance, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, L. Xh., R. D., M. Xh. dhe shoferi I. D. nga **12,760 lekë** secili.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, kreu II, pika 2 germa ç, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Udhëzimin APP nr. 5, datë 27.01.2015 "Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla", UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Sektorin Publik" dhe UMF nr. 33, datë 11.07.2013 "Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë". (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 32-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1- Rekomandimi: Bashkia Poliçan të marrë masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **63,800 lekë** shkaktuar nga komisioni i prokurimit L. Xh., R. D., M. Xh. dhe shoferi I. D. në vlerën **12,760 lekë** secili duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit.

Menjëherë

12- Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr. 273, datë 12.05.2016 në vlerën 42,000 lekë për llogari të operatorit ekonomik "P. D." është kryer pagesë për shërbimin e mirëmbajtjes të mjeteve të transportit sipas urdhër prokurimit me vlera të vogla nr.21 datë 25.04.2016 me fondin limit në vlerën 50,000 lekë pa TVSH, procesverbalit të prokurimeve me vlerë nën 100,000 lekë datë 26.04.2016, procesverbalit datë 21.04.2016 mbajtur nga Stacioni i PMNZH për defekte në mjetet zjarrfikëse dhe për efekt gatishmërie në vlerën 35,000 lekë pa TVSH dhe faturës tatimore nr.59 datë 27.04.2016 për vaj në sasinë 24 litra dhe vlerën 17,280 lekë, guarnicion testate copë 1 në vlerën 9,600 lekë, valvola copë 12 në vlerën 14,400 lekë dhe llampa copë 1 në vlerën 720 lekë.

Fatura nr.59 datë 27.04.2016, në vlerën **42,000 lekë** e paraqitur nga operatori ekonomik "P. D." nuk është dokumentuar në magazinën e Bashkisë Poliçan dhe nuk përmbush kushtet e dokumentit të rregullt për efekt pagese, pasi:

së pari: dokumentet për shërbimet e mirëmbajtjes janë për mallra e materiale lubrifikante të cilat parashikohen në shërbimet e mjetit dhe ato nuk përmbajnë targa të automjetit të cilit i është kryer shërbimi,

së dyti: Në vlerën e mësipërme të shërbimeve të mësipërme prej **42,000 lekë** është përfshirë për blerje vaj në sasinë 24 litra në vlerën **17,280 lekë**, blerje guarnicion testato 1 copë në vlerën **9,600 lekë**, blerje

valvola copë 12 në vlerën **14,400 lekë** dhe blerje llampa copë 1 në vlerën **720 lekë** të cilat nuk janë dokumentuar në magazinë.

Për rrjedhje pagesat e mësipërme konsiderohen si pagesë e pa argumentuar dhe përbëjnë shkëlqje të disiplinës financiare me dëm ekonomik ndaj Bashkisë Poliçan në vlerën **42,000 lekë** dhe detyrim për arkëtim nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, D. Z., O. D., D. H. nga **14,000 lekë** secili. *Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, kreu II, pika 2 germa ç , VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimin APP nr. 5, datë 27.01.2015 “Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Sektorin Publik” dhe UMF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 32-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1- Rekomandimi: Bashkia Poliçan të marrë masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **42,000 lekë** shkaktuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, D. Z., O. D. dhe D. H. nga **14,000 lekë** secili, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr. 671, datë 26.10.2016 në vlerën 166,131 lekë për llogari të operatorit ekonomik “F. A.” është kryer pagesë për shërbimin e mirëmbajtjes të mjeteve të PMNZSH, sipas urdhër prokurimit nr.58 datë 17.10.2016 me fondin limit në vlerën 200,000 lekë pa TVSH, procesverbalit datë 18.10.2016 dhe faturës tatimore nr.2 datë 24.10.2016.

Nga verifikimi i dokumenteve të pagesës së vlerës së mësipërme rezulton sepër 5 procese shërbimi në vlerën **60,900 lekë** janë kryer riparime ndërsa për 8 të tjera në vlerën **105,231 lekë** ato nuk janë shërbime por pjesë këmbimi si: gomina saracineska në sasinë 1 copë dhe vlerën 2,000 lekë, semiaks i pasëm mocoje copë 1 në vlerën 15,000 lekë, motorino benzi copë 1 në vlerën 10,000 lekë, goma benzi copë 2 në vlerën 50,000 lekë, filtro vaji copë 1 në vlerën 2,500 lekë, filtro naftë copë 1 në vlerën 2,400 lekë, filtro ajri copë 1 në vlerën 3,331 lekë dhe tamburo e pasme copë 2 në vlerën 20,000 lekë.

Fatura nr.2 datë 24.10.2016, në vlerën **105,231 lekë** e paraqitur nga operatori ekonomik “F. A.” nuk është dokumentuar në magazinën e Bashkisë Poliçan dhe nuk përmbush kushtet e dokumentit të rregullt për efekt pagese pasi dokumentet për shërbimet e mirëmbajtjes janë për mallra e materiale lubrifikante të cilat parashikohen në shërbimet e mjetit dhe ato nuk përmbajnë targa të automjetit të cilit i është kryer shërbimi,

Për rrjedhje pagesat e mësipërme konsiderohen si pagesë e pa argumentuar dhe përbëjnë shkëlqje të disiplinës financiare me dëm ekonomik ndaj Bashkisë Poliçan në vlerën **105,231 lekë** dhe detyrim për arkëtim nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, A.I, O. D. dhe D. H. nga **35,077 lekë** secili. *Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, kreu II, pika 2 germa ç , VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimin APP nr. 5, datë 27.01.2015 “Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Sektorin Publik” dhe UMF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 32-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1- Rekomandimi: Bashkia Poliçan të marrë masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **105,231 lekë** shkaktuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, A. I., O. D. dhe D. H. nga **35,077 lekë** secili, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Ish komuna Vërtop më datë 24.10.2011 ka lidhur kontratë qeraje nr.8, me subjektin “R.” Sh.p.k. me afat 9 vjet dhe sipërfaqe 40.3 ha tokë, dhe vlerë 2016 lekë/m2/vit. Nga auditimi konstatohet se, subjekti “R.” sh.p.k. për vitet 2016, 2017 nuk ka shlyer detyrimet pranë tatim taksave të Bashkisë Poliçan, duke sjellë si pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik në vlerën **1,626,625 lekë**, përfshirë edhe penaltitetet në masën 0.01% në vit, përcaktuar kjo sipas kushteve të

rëna dakort midis palëve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 194-196 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1- Rekomandimi: Bashkia Poliçan të marrë masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **1,626,625 lekë** shkaktuar nga subjekti “R.” sh.p.k., duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Poliçan, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore **për 9 punonjës** dhe nga verifikimi rezultoi se nuk është dhënë asnjë masë disiplinore. **Për të cilën KLSH rikërkon zbatimin e rekomandimeve për marjen e masave disiplinore për 9 punonjësit si më poshtë:**

1. Z. R. B., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Poliçan. Nga KLSH i është rekomanduar masa disiplinore “**Largim nga shërbimi civil**”, parashikuar në nenin 58, germa (ç) për nëpunësin civil”.

2. Znj. K. Z., në cilësinë e specialistes së Aseteve. Nga KLSH është rekomanduar masa disiplinore “**Nga pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e pagës, për një periudhë deri në dy vjet, deri në largim nga shërbimi civil**”, e parashikuar në nenin 58, për nëpunësin civil.

b. “Nga vërejtje deri në largim nga shërbimi civil” për 7 persona.

1. Znj. A. C., me detyrë Drejtore e Tatim Taksave.

2. Znj. D. Z., në cilësinë e Drejtorit Juridik.

3. Z. O. D., në cilësinë e Drejtorit të Urbanistikës.

4. Z. S. Gj., në cilësinë e Drejtorit të Financës.

5. Z. N. Q.

6. Znj. K. M.

7. Znj. A. H.

12. BASHKIA VAU-DEJËS:

-Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Vau Dejës rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.489/6, datë 31.07.2018, protokolluar në Bashkinë Vau Dejës me shkresën nr. 4051/1, pro., datë 02.08.2018, ndërsa nga Bashkia Vau Dejës për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.4051/2 datë 22.08.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr.489/7 datë 28.08.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nuk është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Vau Dejës, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.489/6, datë 31.07.2018 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 31.01.2019 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA)

Duke qenë se raportimi 6 mujor në KLSH, përkon me verifikimin e zbatimit të rekomandimeve nga KLSH me shkresën nr. 1337, prot, datë 03.12.2018, si dhe shkresës nr. 1337/14, datë 21.12.2018, nga Bashkia Vau Dejës pas përfundimit të verifikimit do të përgatitet dhe do dërgohet pranë KLSH, Raport me shkrim “Mbi zbatimin e rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH”.

B/1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të

ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i Njësisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **41,735,640 lekë**, si më poshtë:

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 12 masa me vlerë 41,735,640 lekë, nga e cila nuk është pranuar nga Subjektet vlerën prej 16,574,285 lekë, e cila përbëhet nga vlera prej 16,268,000 lekë pasi 3 subjekte nuk kanë lidhur kontratë me Bashkinë Vau i Dejës për këto shuma ndërsa vlera prej 306,285 lekë u përket 4 personave për të cilën Bashkia i është drejtuar Ministrisë të Infrastrukturës për mënyrën dhe përcaktimin e bazës së llogaritjes të kësaj takse. Nga vlera prej 41,735,640 mbetet për tu arkëtuar vlera prej 25,161,355 lekë dhe konkretisht:

-Është pranua vlera prej.....	25,161,355 lekë
-Deri me datë 07.02.2019, është arkëtuar vlera prej.....	7,905,741 lekë,
-Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej	17,255,609 lekë

Nga të cilat:

-Në proces arkëtimi 6 rekomandime në vlerën.....	9,532,609 lekë
-Janë njoftuar por nuk kanë paguar 1 rekomandime në vlerën prej.....	7,723,000 lekë

B2. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Vau Dejës, nuk është aplikuar saktë tarifa vendore për pajisjen e subjekteve, me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe as nuk janë arkëtuar vlerat për dhënien dhe përsëritjen e licencave, në shkelje të VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4 dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 10, të trajtuara në aneksit nr.5/3, me pasojë të ardhur të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, në vlerën, në vlerën 5,300,000 lekë ((*Më hollësisht trajtuar në faqen 139- 140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Vau Dejës, Drejtoria e të Ardhurave vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **5,300,000 lekë**, për mos arkëtim diferencë tarife për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, sipas aneksit **nr.5/3 bashkangjitur** Projektraportit të auditimit.

Në vazhdimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e të Ardhurave vendore Bashkia Vau-Dejës, nuk është aplikuar dhe arkëtuar tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Vau-Dejës dhe Njësisive administrative në vartësi, të cilat janë pajisur me leje ndërtimi për objekte të ndryshme private, me fonde jo publike. Nga përllogaritjet e kryera rezulton se për 4 subjekte ndërtimi nuk janë ngarkuar me detyrime për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, në shkelje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës nr.61, datë 30.12.2016, “Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2017”, ndryshuar me vendimin e këshillit të bashkisë nr. 7, datë 24.02.2017, kapitulli II.1, Tarifat, sipas aneksit nr.5/4, me pasojë të ardhur të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, në vlerën 100,000 lekë (*Më hollësisht trajtuar në faqen 141- 142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1.Rekomandimi: Bashkia Vau Dejës, Drejtoria e të Ardhurave, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **100,000 lekë**, për mos

aplikim tarife për subjektet që janë pajisur me leje ndërtimi me fonde private, sipas aneksit nr.5/4 bashkangjitur Projekt raportit të auditimit.

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e të Ardhurave vendore Bashkia Vau-Dejës, nuk është aplikuar dhe arkëtuar tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për çdo vit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Vau-Dejës dhe Njësi administrative në vartësi dhe janë pajisur me leje ndërtimi për objekte të ndryshme, me fonde publike (tendera) përkatësisht:

-për vitin 2016 në vlerën 440,000 lekë

-për vitin 2017 në vlerën 652,500 lekë

nuk janë ngarkuar me detyrime për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, në shkelje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës nr.61, datë 30.12.2016, “Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2017”, ndryshuar me vendimin e këshillit të bashkisë nr. 7, datë 24.02.2017, kapitulli II.1, Tarifave, me pasojë të ardhur të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, sipas aneksit nr.5/5, në vlerën 922,500 lekë (*Më hollësisht trajtuar në faqen 142- 143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1.Rekomandimi:Nga Bashkia Vau Dejës, sektori i taksave dhe tarifave vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **922,500 lekë**, detyrime për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinavesipas aneksit nr.5/5 bashkangjitur Projektraportit të auditimit.

Në vazhdimësi

4.Gjetje nga auditimi:Nga Drejtoria e të ardhurave, sektori i taksave dhe tarifave vendore Bashkia Vau Dejës, nuk janë aplikuar saktë detyrimet për taksat dhe tarifave vendore si taksa trualli, taksa ndërtese, tarifa e pastrimit, tarifa e ndriçimit dhe tarifave e gjelbërimit për qëllime biznesi për 6 subjekte që kanë detyrimin për të paguar, në shkelje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreu II, nenit 9, pika 2; neni 21, pika 2; neni 23/1 dhe Vendimeve të Këshillit të Bashkisë nr.3, datë 20.02.2016, “Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2016”, Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.61, datë 30.12.2016, “Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2017”, ndryshuar me vendimin e këshillit të bashkisë nr. 7, datë 24.02.2017, të Bashkisë Vau-Dejës, sipas aneksit nr.5/6, me pasojë të ardhur të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, në vlerën në vlerën 3,235,942 lekë (*Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 145 -146 të Projekt Raportit të Auditimit*).

4.1.Rekomandimi:Nga Bashkia Vau Dejës, sektori i taksave dhe tarifave vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **3,235,942 lekë**, detyrimet për taksat dhe tarifave vendore si taksa trualli, taksa ndërtese, tarifa e pastrimit, tarifa e ndriçimit dhe tarifave e gjelbërimit për qëllime biznesi, sipas aneksit nr.5/6 bashkangjitur Projektraportit të auditimit.

Në vazhdimësi

5.Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Vau-Dejës, nuk është arkëtuar detyrimi sipas kontratës së qirasë, për kontratat e lidhur midis Bashkisë Vau i Dejës, ish Bashkisë Vau-Dejës, ish Komunës Vig-Mnel, Temal, Shllak dhe Kompanive të telefonisë celulare, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, sipas aneksit nr.5/2, me pasojë të ardhur të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, në vlerën 7,723,000 lekë, përkatësisht:

Ish Bashkia Vau Dejës vlera 3,073,000 lekë

Ish Komuna Vig-Mnelë 1,650,000 lekë

Ish Komuna Temal vlera 1,500,000 lekë

Ish Komuna Shllak vlera 1,500,000 lekë (Më hollësisht trajtuar në faqen 154-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi:Nga Bashkia Vau Dejës, sektori i taksave dhe tarifave vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **7,723,000 lekë**, detyrimet për mos arkëtim qira nga kompanitë e telefonisë celulare, sipas aneksit nr.5/2 bashkangjitur Projekt raportit të auditimit.

Në vazhdimësi

6.Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Vau Dejës, ish Bashkia Vau Dejës, ish Komuna Bushat, nuk janë zbatuar detyrimet kontratuale për arkëtimin e vlerave të përcaktuara në kontratat e lidhura midis Bashkisë dhe subjekteve private, për pasuritë e dhëna me qira si pyje, kullota dhe toka inproduktive, nuk janë arkëtuar për vlerën e plotë, në shkelje të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, kap VI, pikat 1,2,9,10, sipas aneksit nr.5/8, me pasojë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e *Bashkisë Vau-Dejës në vlerën 16,668,000lekë (Më hollësisht trajtuar në faqe 154 -155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1.Rekomandimi:Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me sektorin e pyjeve e kullotave, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **16,668,000lekë**, detyrimet për mos arkëtim nga dhëna me qira pyje, kullota dhe toka inproduktive, sipas aneksit nr.5/8 bashkangjitur Projektraportit të auditimit.

Në vazhdimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Vau Dejës, ish Bashkia Vau Dejës, ish Komuna Vig-Mnel, nuk janë zbatuar detyrimet kontratuale për arkëtimin e vlerave të përcaktuara në kontratat e lidhura midis Bashkisë dhe subjekteve private, për pasuritë e dhëna me qira ndërtesa etj, nuk janë arkëtuar për vlerën e plotë, në shkelje të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, kap VI, pikat 1,2,9,10, sipas aneksit nr.5/9, me pasojë të ardhur të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, në vlerën **611,720 lekë (Më hollësisht trajtuar në faqen 158- 159 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

7.1.Rekomandimi:Nga Bashkia Vau Dejës, sektori i taksave dhe tarifave vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **611,720 lekë**, detyrimet për mos arkëtim nga dhëna me qira për pasuritë ndërtesa etj, sipas aneksit nr.5/9 bashkangjitur Projektraportit të auditimit.

Në vazhdimësi

8.Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Menaxhimit të Territorit, sektori Urbanistik dhe Menaxhimi i Territorit, Bashkia Vau-Dejës nuk është llogaritur saktë taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, nuk është kryer përlllogaritja në bazë të çmimit referencë që është kosto mesatare e ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave, në shkelje të ligjit nr. nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar neni 46, Udhëzimi KM nr.3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2016” dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.61, datë 30.12.2016, “Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2017”, ndryshuar me vendimin e këshillit të bashkisë nr. 7, datë 24.02.2017, sipas aneksit nr. 6/1, me pasojë të ardhur të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, në vlerën 561,215 lekë (*Më hollësisht trajtuar në faqen 175 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1.Rekomandimi:Nga Bashkia Vau Dejës, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Menaxhimit të Territorit, sektori Urbanistik dhe Menaxhimi i Territorit, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **561,215 lekë**, detyrimet për mos arkëtim takse të ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, sipas aneksit nr.6/1 bashkangjitur Projektraportit të auditimit.

Në vazhdimësi

9.Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Vau-Dejës, nuk janë zbatuar detyrimet kontratuale, nuk është arkëtuar detyrimi sipas kontratave tip të qirave të tokave bujqësore të pandara të lidhur midis ish

Bashkisë Vau-Dejës, ish Komunës Bushat dhe personave fizik qiramarrës, gjithashtu nuk janë përlllogaritur kamat vonesat përkatëse për çdo ditë vonesë për mos arkëtimin në kohë të detyrimeve, veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 531, datë 21.8.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, i ndryshuar, UKM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, kreu V, pika 1,2,4,5, sipas aneksit nr. 7/1, me pasojë të ardhur të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, në vlerën 496,522 lekë. (detyrim vlera 451,384 lekë, kamat vonesë 45,138 lekë) (*Më hollësisht trajtuar në faqen 190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1.Rekomandimi:Nga Bashkia Vau Dejës, Drejtoria e Bujqësisë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **496,522lekë**, detyrimet për mos arkëtim qira të tokave bujqësore, sipas aneksit nr.7/1 bashkangjitur Projektraportit të auditimit.

Në vazhdimësi

13. KËSHILLI I QARKUT BERAT:

-Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Qarku Berat rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 55/8 datë 11.05.2018, protokolluar në Qarku Berat me shkresën nr.128/42, datë 04.06.2018 ndërsa nga Qarku Berat për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.2261/2 datë 24.08.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr.490/32 datë 28.08.2018. Pra përgjigja për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes.

-Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Qarkun Berat, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.55/8 datë 11.05.2018 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 11.11.2018 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA),pra nuk ka raportuar.

A. MASA ORGANIZATIVE

Nga KLSH i janë rekomanduar Qarkut Berat 5 masa organizative, të cilat janë pranuar dhe prej tyre, është zbatuar plotësisht 1 masë, janë në proces zbatimi 4 , masa dhe nuk ka masë organizative të pa zbatuar. KLSH rikërkon zbatimin e plotë të 4 rekomandimeve në proces zbatimi të detajuara si më poshtë:

1-Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Qarkut Berat (DAMT), bazuar në dokumentacionin e Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefekturës së Qarkut Berat (KVVTP) lidhur me vendimet për heqjen e titullit të pronësisë të përfituar në mënyrë të padrejtë, të konfirmuara me vendime gjyqësore të formës së prerë, për **14 raste** me një sipërfaqe prej **76 835 m²**, është realizuar vetëm marrja dokumentare në dorëzim e sipërfaqeve që do të kalojnë në emër të shtetit. Konstatohet se aktiviteti i kësaj Drejtorie është kufizuar vetëm në evidentimin e kësaj sipërfaqe në pronësi shtet ndërkohë që nuk është vijuar me procedurat për klasifikimin sipas zërave kadastrale dhe më pas për hartimin e planeve zhvillimore të nevojshme për funtjen e këtyre sipërfaqeve nën administrim shtetëror. Konstatohet një kuptim i ngushtë i funksioneve të përcaktuara në nenin 12 të ligjit nr.8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe Mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar

Nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Qarkut Berat (DAMT), është bërë marrja në dorëzim e sipërfaqeve me diferenca nga Vendimi i KVVTP pranë Prefekturës së Qarkut Berat dhe AMTP-të. Kështu bazuar në dokumentacionin e KVVTP pranë Prefekturës së Qarkut Berat sipas vendimit nr. 236, datë 24.10.2013, mbi shfuqizimin e plotë të AMTP-së nr. 173, datë 25.06.1996 dhe kthimin e sipërfaqes prej 10 490 m² në pronësi shtet, vendim i lënë në fuqi nga Gjykatat, bazuar në procesverbalin e datë 28.01.2015 marrja në dorëzim e sipërfaqes është bërë për 9 250 m² ose më

pak se vendimi i Komisionit Vendor (KV) dhe vendimi i Gjykatës për sipërfaqen prej 1 240 m². Ndërsa referuar dokumentacionit të KVVTP pranë Prefekturës së Qarkut Berat për vendimin nr. 176, datë 31.03.2011, i cili ka vendosur shfuqizimin e AMTP-ve nr. 49-207 dhe nr. 207, datë 01.06.1992 dhe kthimin e sipërfaqeve prej 19887 m² në pronësi shtet, në fakt sipas rocesverbalit të marrjes në dorëzim datë 28.01.2015 është marrë në dorësim sipërfaqja 8505 m², pra me një diferencë prej 11382 m². Nuk konstatohet asnjë analizë për shkaqet e këtyre diferencave për të qartësuar nëse ka përgjegjësi për tu evidentuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 79-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1-Rekomandimi: Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Qarkut Berat (DAMT), të merret me hartimin e strategjisë për një administrim të kujdesshëm të fondit të tokës, bazuar në strategjinë sektoriale dhe kuadrin rregullator në fuqi, të marrë masa për njohjen mirë të funksioneve që i ka dhënë ligji dhe për ta kthyer këtë drejtori në njësi funksionale në menaxhimin e tokës në dispozicion.

Në vazhdimësi

2-Gjetje nga auditimi: Buxheti i Këshillit të Qarkut Berat është përqendruar vetëm në realizimin e shpenzimeve korente, ndërsa nuk është gjithë përfshirës sepse fondet për përmirësim e infrastrukturës së rrugëve rurale, financimin e projekteve dhe studime e projektme për investime veçanërisht për njësitë e qeverisjes vendore me burime të pakta, të ardhurash janë në nivelin (0), për pasojë nëpërmjet buxhetimit Këshilli i Qarkut nuk ka arritur objektivat për pjesëmarrje me financim të projekteve dhe studime për projektme, veprim në mospërputhje me procedurat e UMF nr.2, datë 06.02.2012 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” pika 121, pasi nuk janë mbajtur akt-marrëveshje për detyrimin vjetor të NJQV ndaj KQ, nuk janë bërë përpjekje për transferimin e këtyre kuotave nga NJQV në favor të KQ. Plan buxheti përfundimtar është miratuar nga KQ Berat jashtë afateve ligjore, të cilat kanë sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e Këshillit të Qarkut në vlerën totale 34,732 mijë lekë**, si pasojë e formalizmit në programimin e tregueseve të buxhetit dhe burimeve të financimit, në mospërputhje me neni 32 “*Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vendor*”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 84-91 të Raportit të Auditimit*).

2.1-Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Berat të marr masa që programimi dhe buxheti në planin financiar të vitit raportues të jetë gjithëpërfshirës, ndërsa prioritet ti jepet realizimit të të ardhurave nga zbatimi i kuotave të anëtarësisë së Njësisë së Qeverisjes Vendore.

Në vazhdimësi

3- Gjetje nga auditimi: Projekti “Rikonstruksion i rrugës Kuc-Malas, Bashkia Ura Vajgurore” është zbatuar në mungesë të lejes së ndërtimit. Këshilli i Qarkut Berat nuk ka aplikuar për leje ndërtimi për projektin e “Rikonstruksion i rrugës Kuc-Malas, Bashkia Ura Vajgurore”, dhe ka prokuruar zbatimin e këtyre punimeve në mungesë të lejes së ndërtimit. Mungesa e lejes së ndërtimit të objektit është në kundërshtim me nenin 39 të Ligjit nr.107, datë 31.07.2014 “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*” të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 68-75 të Raportit të Auditimit*).

Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligj.

3.1- Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Berat për të gjitha projektet, të cilat sipas ligjit të sipërcituar duhet të pajisen me leje ndërtimi, të aplikojë për leje pranë bashkive përkatëse apo Këshillit Kombëtar të Territorit, sipas rastit, para se të nisë procedurën e prokurimit të punimeve.

Në vazhdimësi

4- Gjetje nga auditimi: Këshilli i Qarkut Berat ka hartuar projektin e rikonstruksionit dhe asfaltimit të rrugës lagja “Pjeshkorja” faza II, Bashkia Berat, në tejkalim të kompetencave të tij, pasi Drejtoria e Planifikimit të Territorit në Këshillin e Qarkut Berat, nëpërmjet inxhinierëve të saj, ka hartuar në nëntor të viti 2014 projektin e rikonstruksionit dhe asfaltimit të kësaj rruge, në situatë kur legjisllacioni në fuqi nuk i lejon si kompetencë punonjësve të Këshillit të Qarkut Berat që të hartojnë projekte. Inxhinierët projektues nuk kanë paraqitur licencat profesionale. Sa më sipër është në kundërshtim me

ligjin nr.107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i cili ka hyrë në fuqi në datën 01.10.2014, dhe në zbatim të nenit 11 i lë përgjegjësi Këshillit të Qarkut si vijon:

1. Këshilli i qarkut është përgjegjës për koordinimin e proceseve të planifikimit në nivel qarku.
2. Këshilli i qarkut miraton, sipas rastit, nismën dhe dokumentet e planifikimit sektorial të qarkut.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 68-75 të Raportit të Auditimit).

4.1- Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Berat në zbatim të ligjit nr.107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar, të përgjigjet për ngritjen e strukturave për koordinimin e proceseve të planifikimit dhe miratimit të nismës së proceseve të planifikimit në nivel qarku. Të gjitha shërbimet e konsulencave të prokurohen sipas kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Në vazhdimësi

5- Gjetje nga auditimi: Për projektin e “Rikonstruksionit dhe asfaltimit të rrugës lagja Pjeshkorja faza II, Bashkia Berat”, sipërmarrësi i punimeve “B.” shpk nuk ka hartuar dokumentacionin topografik të faktit për vendosjen e objektit në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” si edhe është shkëlur afati i emërimit të kolaudatorit të punimeve, pasi emërimi i kolaudatorit “M.” shpk është bërë 5 muaj pas përfundimit të punimeve të ndërtimit, në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar.

Emërimi i kolaudatorit apo i grupit të kolaudimit është detyrë e investitorit, i cili duhet që këtë t’ia komunikojë personit, institucionit që do të merret me kolaudimin dhe seksionit ose zyrës së urbanistikës të rretheve apo bashkive, brenda 30 ditëve nga përfundimi i punimeve të ndërtimit.

Shkelja e afatit të emërimit të kolaudatorit ka sjellë vonesë në kryerjen e kolaudimit të objektit dhe marrjes në dorëzim të punimeve nga investitori, ndërsa mos hartimi i dokumentacionit topografik të faktit ka vështirësuar kontrollin e saktësisë dhe cilësisë së punimeve (Trajtuar më hollësisht në faqet 68-75 të Raportit të Auditimit).

5.1- Rekomandimi: Për të gjitha punimet e ndërtimit, për të cilat investitor është Këshilli i Qarkut Berat, ky i fundit të zbatojë afatin 30 ditor të emërimit të kolaudatorit dhe të kërkojë plotësimin e dokumentacionit teknik nga ana e zbatuesit të punimeve.

Në vazhdimësi

B/1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, KLSH i ka rekomanduar **Kryetarit të Këshillit të Qarkut Berat**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 2.788.374 lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e 12 rekomandimeve nga KLSH prej.....2.788.374 lekë

-Nuk janë pranuar vlera prej.....30,900 lekë

-Janë pranuar.....2,757,474 lekë

-Deri më datën 31.12.2018 janë sistemuar apo arkëtuar 2 rekomandime..... 292,000 lekë

- Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej.....2,465,474 lekë

Nga të cilat:

-Në proces arkëtimi 4 rekomandime në vlerën..... 2.135,414 lekë

-Janë nisur njoftimet për 5 rekomandime por skanë filluar arkëtimet330.400 lekë.

1.2-Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Blerje mjete fadromë për Ndërmarrjen e Rrugëve Rurale Skrapar*” është shkaktur **dëm ekonomik** shuma 238,200 lekë pa tvsh për buxhetin e Këshillit të Qarkut, shpenzim i paligjshëm i shkaktuar si diferencë ndërmjet ofertave konkurruese nga skualifikimi i ofertës ekonomike me vlerë me të ulët dhe vlerësimi i ofertës ekonomike me vlerë më të lartë, në mospërputhje me neni 52 “*Hapja e ofertave*” pikat (1); (6), neni 53/3 “*Shqyrtimi ofertave*”, neni 54 “*Alternativat*”, neni 55 “*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*” të LPP, (*Trajtuar më hollësisht në faqet 58-68 të Raportit të Auditimit*).

1.2.1-Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Berat të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **238,200 lekë pa tvsh**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë solidare sa më poshtë;

1-z.A. G. **shuma 79,400 lekë.**

2-z.A. H. **shuma 79,400 lekë.**

3-z.L. S. **shuma 79,400 lekë.**

Menjëherë

2.4-Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr.96, datë 11.03.2015 është kryer pagesa në shumën 365,800 lekë pa tvsh me përfitues subjekti “*Q.*”shpk për likuidimin e shpenzimit shërbim emergjence me objekt; “*Mbi bllokimin nga dëbora të segmenteve Gjerbës -Dëvri, Zogas-Potom nga data 01-10.02.2015*”, pagesë e kryer me dokumenta shoqëruese të pa justifikuar dhe të pa argumentuar me pasojë likuidim për punime të pa kryera, në mospërputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” neni 4/24;10;11;12; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik*”, pika 35; 36 dhe pikën 7 të Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015 me pasojë **dëm ekonomik** shuma **365,800 lekë pa tvsh** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 58-68 të Raportit të Auditimit*).

2.4.1-Rekomandim: Këshilli i Qarkut Berat të marr masat dhe të ndjekë në rrugë ligjore procedurat administrative për arkëtimin e shumës **365,800 lekë pa tvsh** nga subjekti “*Q.*”shpk e përfituar tepër për punime të pakryera.

Menjëherë

3.5- Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr.169, datë 24.04.2015 është kryer pagesë në shumën 134,538 lekë pa tvsh me përfitues subjekti “*B.*”shpk për likuidimin e shpenzimit shërbim emergjence me objekt; “*Mbi bllokimin e rrugës kthesa pronovik uji zi*”, pagesë e kryer me dokumenta shoqëruese të pa justifikuar dhe të pa argumentuar me pasojë likuidim për punime të pa kryera, në mospërputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” neni 4/24;10;11;12; UMF nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik*”, pika 35; 36 dhe pikën 7 të Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015 me pasojë **dëm ekonomik** shuma **134,538 lekë pa tvsh** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 58-68 të Raportit të Auditimit*).

3.5.1-Rekomandim: Këshilli i Qarkut Berat të marr masat dhe të ndjekë në rrugë ligjore procedurat administrative për arkëtimin e shumës **134,538 lekë pa tvsh** nga subjekti “*B.*” shpk e përfituar tepër për punime të pakryera.

Menjëherë

4.6- Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzim nr.171, datë 27.04.2015 është kryer pagesa në shumën 20,000 lekë, për znj.E. Z. eksperte juridike dhe znj.N. Dh. eksperte ekonomike, shpenzim për likuidimin e pagesës së kryer me objekt; “*Shpërblim për ekspert në komisioni i ngritjes në detyrë në konkurimin e kryer në datë 08.04.2015*”, pagesë e kryer me dokumenta shoqëruese të pa justifikuar dhe të pa argumentuar, në mospërputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” neni 4/24;10;11;12 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik*”, pika 35; 36, me pasojë **dëm ekonomik** shuma **20,000 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 37-57 të Raportit të Auditimit*).

4.6.1-Rekomandim: Këshilli i Qarkut Berat të marr masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **20,000 lekë** nga punonjësit përfitues në mënyrë solidare sa më poshtë:

1-znj.E. Z. shuma **10,000 lekë.**

2-znj.N. Dh. shuma **10,000 lekë.**

Menjëherë

5.7- Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr.24, datë 29.04.2015 në procedurën e prokurimit “blerje e vogël” e zhvilluar me objekt; “Blerje goma për mjete fadromë” është shkaktur **dëm ekonomik** shuma **14,760 lekë pa tvsh** për buxhetin e Këshillit të Qarkut, shpenzim i paligjshëm i shkaktuar si diferencë ndërmjet ofertave konkurruese nga skualifikimi i ofertës ekonomike me vlerë me të ulët dhe vlerësimi i ofertës ekonomike me vlerë më të lartë, në mospërputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 32 “Llojet e procedurave të prokurimit”, germa (ë) “Prokurimi me vlerë të vogël” dhe Udhëzimi APP nr.3, datë 27.01.2015 “Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël”, (Trajtuar më hollësisht në faqet 58-68 të Raportit të Auditimit).

5.7.1- Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Berat të marr masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **14,700 lekë pa tvsh**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit Blerje e Vogël, në mënyrë solidare sa më poshtë:

1-Z.A. H. shuma **4,900 lekë**.

2-Znj.B. V. shuma **4,900 lekë**.

3-Z.A. G. shuma **4,900 lekë**.

Menjëherë

6.8- Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr.259, datë 09.07.2015 në procedurën e prokurimit “blerje e vogël” e zhvilluar me objekt; “Rrethim vorreza Palikesh” është shkaktur **dëmi ekonomik** në shumën **78,000 lekë pa tvsh** për buxhetin e Këshillit të Qarkut Berat, shpenzim i paligjshëm i shkaktuar si diferencë ndërmjet ofertave konkurruese nga skualifikimi i ofertës ekonomike me vlerë me të ulët dhe vlerësimi i ofertës ekonomike me vlerë më të lartë, në mospërputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 32 “Llojet e procedurave të prokurimit”, germa (ë) “Prokurimi me vlerë të vogël” dhe pika 5 e Udhëzimi APP nr.3, datë 27.01.2015 “Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël” (Trajtuar më hollësisht në faqet 58-68 të Raportit të Auditimit).

6.8.1- Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Berat të marr masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **78,000 lekë pa tvsh**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit Blerje e Vogël, në mënyrë solidare sa më poshtë:

1-z.A. H. shuma **26,000 lekë**.

2-Znj.B. V. shuma **26,000 lekë**.

3-Znj.A. G. shuma **26,000 lekë**.

Menjëherë

7.9-Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr.346, datë 03.09.2015 në procedurën e prokurimit “blerje e vogël” e zhvilluar me objekt; “Rikonstruksion i rrugës Kulmak” është kryer pagesa në shumën 153,000 lekë pa tvsh me përfitues subjekti “T. M.” person fizik, pagesë e kryer me dokumenta shoqëruese të pa justifikuara dhe të pa argumentuara me pasojë likuidim i punimeve të pa kryera, në mospërputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24;10;11;12; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e asetëve në sektorin publik”, pika 35; 36 dhe Udhëzimi nr. 3, datë 27.01.2015 me pasojë **dëm ekonomik** shuma **153,000 lekë pa tvsh** (Trajtuar më hollësisht në faqet 58-68 të Raportit të Auditimit).

7.9.1-Rekomandim: Këshilli i Qarkut Berat të marr masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **153,000 lekë pa tvsh** nga subjekti “T. M.” person fizik, përfituar tepër për punime të pakryera.

Menjëherë

8.10- Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimi nr. 238, datë 04.10.2016 është kryer pagesa në shumën 10,000 lekë për likuidimin e shpenzimit të kryer me objekt; “Dieta brenda vendit” e përfituar nga punonjësi i administratës së K.Qarkut me destinacion (Tiranë e Gjirokastër) pa dokumenta justifikuese dhe argumentuese, në mospërputhje me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar, me pasojë **dëm ekonomik** shuma **10,000 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 37-57 të Raportit të Auditimit).

8.10.1- Rekomandim: Këshilli i Qarkut Berat të marr masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **10,000 lekë** nga punonjësi përfitues i shpenzimit z. E. B..

Menjëherë

9.9.12- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Kuc-Malas, Bashkia Ura Vajgurore”, me kontraktor “S.” sh.p.k, rezultoi se trashësia e shtresës së cakëllit e përdorur në objektin është më e vogël se ajo e përcaktuar në projekt-preventivin e punimeve.

Nga matjet e kryera në terren përsa i përket trashësisë së shtresës së cakëllit të përdorur, rezultojnë se trashësia mesatare e saj është 10 cm. Pra ndonëse sipërmarrësi i punimeve është paguar për shtrimin e një shtrese prej 15 cm, në realitet shtresa në mesataren e saj nuk i kalon 10 cm. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” të ndryshuar.

Pika 9. Vlera e zërave të punës të situacioneve të ndërtimit del nga prodhimi i volumeve të punës, të llogaritura në librezën e masave të zbatimit me çmimet për njësi të llogaritura mbi bazën e analizave teknike të punimeve të ndërtimit, sipas vlerave faktike.”

si edhe me Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu II, pika 8 dhe 8.1

8. Punimet e përfunduara dhe të marra në dorëzim në kantier paraqiten nga sipërmarrësi në situacione pjesore, sipas periudhave progresive të zhvillimit të punimeve, dhe në atë përfundimtar.

8.1 Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës.

Duke ju referuar sasisë prej 7,739 m² dhe cmimit prej 500 lekë/m² të zërit të punimit 3.210 “Shtresë cakëlli mbeturinë kave t=15cm, përhapur e ngjeshur me makineri”, të paraqitur në situacionin përfundimtar, rezultojnë se vlera e punimeve të paguara, por të pa kryera është **1,289,860 lekë që përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit (Trajtuar më hollësisht në faqet 68-75 të Raportit të Auditimit).**

9.12.1- Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Berat të kërkojë arkëtimin e dëmit nga subjekti “S.” shpk për vlerën **1,289,860 lekë, të përfituar padrejtësisht.**

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

D.1-Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH^{së} të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 gjerat “g” dhe “k” të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” **KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Këshillit të Qarkut Berat, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit të Këshillit të Qarkut Berat, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për 2 punonjës:**

a-“Vërejtje” e parashikuar nga neni 58, shkronja (a) të ligjit nr. 152/2013, për 2 nëpunësit civil, si më poshtë:

1.A. P. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT), Qarku Berat. (nuk është zbatuar)

2.F. Dh. me detyrë Specialist në Këshillin e Qarkut, Berat, në cilësinë anëtar i komisionit të blerjeve me vlerë e vogël. (nuk është zbatuar)

E. MASA ADMINISTRATIVE;

E/I. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Mbështetur në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike në nenet 4, 12, 19/7, 21, 23, 25, 28, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 46, 53, 56, 63, 77, etj, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar në aktkonstatimin dhe vërejtjet, komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe nenin 15 germa (c, ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", **KLSH i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik** të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (*dënim me gjobë*) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), të 4 punonjësve për 2 procedura prokurimi,

Nga verifikimi rezultoi se APP me vendimin nr.67, datë 12.07.2018 percjellë për në Qarkun Berat, duke vendosur masa dënim me gjobë për 11 persona në vlerën në total prej **530,000 lekë**.

Nga Këshilli i Qarku Berat janë njoftuar 5 personat për vendimet e gjobave nga APP, me urdhrat e brendshëm respektivisht: nr. 193,194,195,196,197,198,199,200,201,202,203 te datës 8.10.2018, **ndërkohë që 6 vendime gjobe në vlerën 170,000 lekë, nuk pranohen nga Këshilli i Qarkut Berat.**

1-z.A. G. me detyrë ish/Drejtor i Kordinimit në Këshilli i Qarkut Berat, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për marrje në dorëzim të mjetit në kushte jashtë specifikimeve teknike DST në kontratën e lidhur dhe të likuiduar. Me vendimin e APP nr.67, datë 12.07.2018 është gjobitur në shumën 80,000 lekë. Deri më datën 31.12.2018 është arkëtuar shuma prej 0 leke duke mbetur në proces arkëtim edhe shuma prej 80,000 lekë.

2-z.L. S., me detyrë ish/Specialist në Këshilli i Qarkut Berat, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për marrje në dorëzim të mjetit në kushte jashtë specifikimeve teknike DST në kontratën e lidhur dhe të likuiduar.Me vendimin e APP nr.67, datë 12.07.2018 është gjobitur në shumën 80.000 lekë. Deri më datën 31.12.2018 është arkëtuar shuma prej 0 leke duke mbetur në proces arkëtim edhe shuma prej 80,000 lekë.

3-z.V. M., me detyrë ish/Specialist në Këshilli i Qarkut Berat, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për marrje në dorëzim të mjetit në kushte jashtë specifikimeve teknike DST në kontratën e lidhur dhe të likuiduar.Me vendimin e APP nr.67, datë 12.07.2018 është gjobitur në shumën 60.000 lekë. Deri më datën 31.12.2018 është arkëtuar shuma prej 0 leke duke mbetur në proces arkëtimi edhe shuma prej 60,000 lekë.

Shtesa

5-G. A...Me vendimin e APP nr.67 datë 12.07.2018 është gjobitur në shumën 60.000 lekë . Deri më datën 31.12.2018 është arkëtuar shuma prej 0 leke duke mbetur në proces arkëtim edhe shuma prej 60.000 lekë.

6-A. H...Me vendimin e APP nr.67, datë 12.07.2018 është gjobitur në shumën 80.000 lekë . Deri më datën 31.12.2018 është arkëtuar shuma prej 0 leke duke mbetur në proces arkëtim edhe shuma prej 80.000 lekë.

Mbi mos pranimin nga Këshilli i Qarkut Berat për 6 vendimet e gjobave të vendosura nga APP në vlerën 170,000 lekë.

Nga ana e Këshillit të Qarkut Berat, pretendohet se: Mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për Vete Qeverisjen Vendore",neni 83,ligjin nr.9643 date 20.11.2006 "Për prokurimin publik " i ndryshuar neni 72 "Kundërvajtjet administrative", pika 4 "Përgjegjësia për vjeljen e gjobave, të vendosura sipas pikës1,të këtij neni, është e autoritetit kontraktor".

1.Të mos bëhet vjelja e gjobave të vendosura nga Agjencia e Prokurimit Publik me shkresën nr. 5224/3 prot, datë 12/07/2018 për :

1- znj. D. T. në shumën 20,000 (njëzet mijë) lekë

2- znj.B. H. në shumën 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë

3- z.Dh. P. në shumën 20,000 (njëzet mijë) lekë

4- z.P. O. në shumën 30,000 (tridhjetë mijë) lekë,

5- z.Xh. T. në shumën 20,000 (njëzet mijë) lekë

6- z.A. A. në shumën 20,000 (njëzet mijë) lekë

7-1. A. A. Me vendimin e APP nr.67, datë 12.07.2018 është gjobitur në shumën 20.000 lekë. Deri më datën 31.12.2018 është arkëtuar shuma prej 0 lekë.(Ka dalë urdhri nr. 228, datë 27.12.2018 për mosvjeljen e gjobave)

8-2. B. (H.) V. Me vendimin e APP nr.67, datë 12.07.2018 është gjobitur në shumën 60.000 lekë. Deri më datën 31.12.2018 është arkëtuar shuma prej 0.(Ka dalë urdhri Nr 228 datë 27.12.2018 për mosvjeljen e gjobave)

9-3. D. T. Me vendimin e APP nr.67, datë 12.07.2018 është gjobitur në shumën 20.000 lekë. Deri më datën 31.12.2018 është arkëtuar shuma prej 0 leke.(Ka dalë urdhri Nr 228 datë 27.12.2018 për mosvjeljen e gjobave)

10-4. Xh. T. Me vendimin e APP nr.67 datë 12.07.2018 është gjobitur në shumën 20.000 lekë. Deri më datën 31.12.2018 është arkëtuar shuma prej 0 leke. (Ka dalë urdhri Nr 228 datë 27.12.2018 për mosvjeljen e gjobave)

11-5. P. O. Me vendimin e APP nr.67 datë 12.07.2018 është gjobitur në shumën 30.000 lekë. Deri më datën 31.12.2018 është arkëtuar shuma prej 0 leke.(Ka dalë urdhri Nr 228 datë 27.12.2018 për mosvjeljen e gjobave)

12-6. Dh. P. Me vendimin e APP nr.67 datë 12.07.2018 është gjobitur në shumën 20.000 lekë. Deri më datën 31.12.2018 është arkëtuar shuma prej 0 leke.(Ka dalë urdhri Nr 228 datë 27.12.2018 për mosvjeljen e gjobave)

Qëndrimi i grupit të audituesve shtetërorë: KLSH, nuk është dakord me urdhrin e kryetarit të Këshillit Qarkut Berat z.F. A. Nr. 228, datë 27.12.2018 për mosvjeljen e gjobave për 6

persona në shumën 170,000 lekë, si më poshtë:

1- znj. D. T. në shumën 20,000 (njëzet mijë) lekë

2- znj.B. H. në shumën 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë

3- z.Dh. P. në shumën 20,000 (njëzet mijë) lekë

4- z.P. O. në shumën 30,000 (tridhjetë mijë) lekë,

5- z.Xh. T. në shumën 20,000 (njëzet mijë) lekë

6- z.A. A. në shumën 20,000 (njëzet mijë) lekë

Pasi ky urdhër bie në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe nënligjor si më poshtë:

Rekomandim nr. 1, sa sipër KLSH kërkon anulimin e urdhrin të kryetarit të Këshillit Qarkut Berat z.F. A. Nr. 228, datë 27.12.2018 për mosvjeljen e gjobave të vendosura nga Agjensia e Prokurimit Publik me shkresën nr. 5224/3, prot, datë 12.07.2018, për 6 persona në shumën 170,000 lekë dhe rikërkon vazhdimin e procedurave për vjeljen e 6 vendimeve të gjobave në vlerën 170,000 lekë, të vendosura nga APP me vendimin e APP nr.67 datë 12.07.2018 si më poshtë:

1- znj. D. T. në shumën20,000 (njëzet mijë) lekë

2- znj.B. H. në shumën..... 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë

3- z.Dhimiter Pitikoja në shumën..... 20,000 (njëzet mijë) lekë

4- z.P. O. në shumën..... 30,000 (tridhjetë mijë) lekë,

5- z.Xh. T. në shumën20,000 (njëzet mijë) lekë

6- z.A. A. në shumën20,000 (njëzet mijë) lekë

Po kështu të llogariten kamat vonesat si më poshtë:

Rekomandim nr. 2:

Për gjobat e vendosura nga APP, me vendimin nr.67, datë 12.07.2018, nga Këshilli i Qarkut Berat, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës të kontabilizohen vlera e vendimeve të gjobave të vendosura nga APP, KLSH rikërkon që të meren masat e mëposhtme:

a) Të marrë masa për dërgimin në Gjykatë dhe kthimin në tituj ekzekutiv, **të 11 vendimeve të gjobave në vlerën 530,000 lekë**, të vendosura nga APP, sikurse parashikohet në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, konkretisht në nenin 24-*Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv*.

b) Të marrë masa për llogaritjen e kamat vonesave për 11 gjobat **në vlerën 530,000 lekë** të vendosura nga APP, bazuar në ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, **neni 30-”Arkëtimi i shumave të detyrimeve”** ku parashikohet se: 3.Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë paguhet **kamat 2 për qind në muaj të masës gjobës**, me përjashtim të rasteve kur ligji i posaçëm parashikon përqindje të ndryshme për kamatë vonesat, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Emri	Mbiemri	Vendosur gjobë Shuma lekë Vendimi APP nr.54, datë 05.06.2018	Arkëtuar Deri 31.12.18	Pa u arkëtuar Deri 31.12.2018	Muaj Pa paguar 01.07.2018 28.02.2019	2 % Në muaj Lekë/muaj	Kamat vonese 2 %/muaj 8 muaj x 2% = 16 %	Gjithsejt Detyrimi më dt.28.02. 2019	Nga te cilat:		
										Në proces arketimi	Në proces Gjyqësor	Nisur njoft e skanë paguar
a	b	c	1	2	3	4	5	6 (4 x 5)	7 (3+6)	8	9	10
1	B.	V	60.000	0	60.000	8	1,200	9,600	69,600			
2	D.	T	20.000	0	20.000	8	400	3,200	23,200			
3	Xh	T	20.000	0	20.000	8	400	3,200	23,200			
4	G	A	60.000	0	60.000	8	1,200	9,600	69,600			
5	P	O	30.000	0	30.000	8	600	4,800	34,800			
6	D	P	20.000	0	20.000	8	400	3,200	23,200			
7	V	M	60.000	0	60.000	8	1,200	9,600	69,600			
8	A	G	80.000	0	80.000	8	1,600	12,800	92,800			
9	L	S	80.000	0	80.000	8	1,600	12,800	92,800			
10	A	H	80.000	0	80.000	8	1,600	12,800	92,800			
11	A	A	20.000	0	20.000	8	1,200	3,200	23,200			
	Shuma		530.000		530.000	88	10,201	84,800	614,800			

c. Kryetari i Këshillit të Qarkut berat, **të fillojë procedurat largimit nga puna**, ndaj personit përgjegjës i cili nuk ka nisur procedurat e nevojshme ligjore të vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të gjobës), bazuar në ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, pika 5) ku parashikohet se **-neni 44” Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”**, në rast se gjobat dhe detyrimet e tjera, të vendosura nga vendimi për kundërvajtjen administrative, nuk paguhet për mosveprim të punonjësit të organit administrativ, i cili ka miratuar vendimin përkatës dhe detyrimin që të kërkojë arkëtimin e shumave, apo për shkak se punonjësi nuk nis procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ, **atëherë ndaj tij fillojnë procedurat e largimit nga puna.**

d. Drejtoria Juridike, bazuar në nenet 151 dhe 152, të “Kodit Procedurës Civile në RSH”, të marrin masa dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për vendimet e dënimit me gjobë të vendosura nga APP, të cilave u ka kaluar afati ligjor 2 vjeçar, duke shtuar në kërkesat drejtuar Gjykatës edhe llogaritjen e kamat vonesave .

e) Bazuar në ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 4. Përgjegjësia për vjeljen e gjobave, të vendosura sipas pikës 1, të këtij neni, është e autoritetit kontraktor. Për mos nxjerrjen e urdhrave dhe njoftimeve për ekzekutimin e vendimit të APP nr.67, datë 12.07.2018, për 11 persona në vlerën në total prej 650.000 lekë dhe mos fillimin e procedurave ligjore për kryerjen e ndalesave z. F. A. kryetari i Këshillit të Qarkut Berat, bëhet përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të parashkrimit të vendimeve prej 2 vjetësh (vlerave) të gjobave të përcaktuar në nenin 46 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, sipas vendimeve administrative të dënimit me gjobë.

D- PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër në **Këshillin e Qarkut Berat**, (Njësia e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe

nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionarin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

E. TË TJERA:

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces sipas rezultateve të këtij auditimi, kërkohet dhe inkurajohet përsheptimin e plan veprimit për realizimin e plotë të tyre brenda 20 ditëve nga marrja e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

Pavarësisht auditimit që ne kemi kryer për zbatimin e rekomandimeve, ju kujtojmë që në mbështetje të nenit 30, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **jeni të detyruar që brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës,** duhet të raportoni me shkrim pranë KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve tona dërguar me shkresat përkatëse si, dhe ju bëjmë me dije se zbatimi i rekomandimeve do të jetë pjesë e auditimit të radhës nga KLSH, në subjektin Tuaj.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

Shënim 1: Pika **E-TË TJERA** e këtij vendimi vlen për të gjitha subjektet objekt të këtij auditimi të cilat nuk kanë zbatuar rekomandimet e lëna nga KLSH-ja.

BUJAR LESKAJ

KRYETAR